



**Gjuha, kultura dhe zakonet e
komuniteteve etnike në Malin e Zi**



Gjuha, kultura dhe zakonet e komuniteteve etnike në Malin e Zi

Podgoricë, Mars, 2021

Botues



Titulli publikimit

Gjuha, kultura dhe zakonet e komuniteteve etnike në Malin e Zi

Për botuesin

Boris Raoniq

Redaktorja

Edina Hasanaga Çobaj

Përkthyes

Admir Gjoni

Dizajni dhe kopertina

APPrint

Shtypshkronja

APPrint

Tirazhi

50 copë

 GradjanskaAlijansaCG

 @GACrnaGora

 gradjanskaalijansa

 office@gamn.org

 www.gamn.org

 Studentska ulica br. 21/a, Lamela 9, st. 5, Podgorica

 +382 20 513 687

Projekti i mbështetur nga ana:



Ministria e Drejtësisë, të Drejtave të
Njeriut dhe Pakicave

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-741-12-9
COBISS.CG-ID 16781572

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

Citimi dhe përdorimi i informacionit nga botimi lejohet me citimin e detyrueshëm të burimit dhe pronarit të së drejtës së kopjimit.

Përdorimi i materialit për ndonjë qëllim tjetër nuk lejohet pa miratimin paraprak të Aleancës Qytetare.

Për pjesët e botimit të marra nga burime të jashtme, Aleanca Qytetare nuk është përgjegjëse.

PËRMBAJTJA:

Hyrje.....	4
Gjuha, kultura dhe zakonet e shqiptarëve në Malin e Zi	
Lufta për mbijetesë, Ismet Kallaba.....	5
Gjuha, kultura dhe zakonet e boshnjakëve në Malin e Zi	
Diversiteti dhe veçantia, pjesë e mozaikut unik, Edin Smailović	11
Gjuha, kultura dhe zakonet e malazezëve në Malin e Zi	
Frytet e shkëmbit, Vukan Razhnatović	16
Gjuha, kultura dhe zakonet e kroatëve në Malin e Zi	
Frytet e detit, Marija Saulačiq dhe Martina Saulačiq Llompar	23
Gjuha, kultura dhe zakonet e myslimanëve në Malin e Zi	
Mërkoti, perla e pahulumtuar, Sabrija Vuliq.....	33
Gjuha, kultura dhe zakonet e romëve në Malin e Zi - Kultura e cila e ka mundur harresën në Mal të Zi: koha për t’ua hapur dyert romëve, Elvis Berisha	39
Gjuha, kultura dhe zakonet e serbëve në Malin e Zi	
Pse harresa është mëkat, Mr Millorad Durutović.....	45

HYRJE

Të nderuar lexues,

Para juve është botimi i ri i Buletinit të Shkollës së Studimeve Politike me titull “Gjuha, kultura dhe zakonet Ministria e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave.

Ky botim është dizajnuar si një kontribut konkret në qëllimet strategjike të politikës shtetërore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave, me qëllim të prezantimit të kulturave dhe traditave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave në Mal të Zi. Ne besojmë se aktivitete të tilla mund të kontribuojnë ndjeshëm në njohjen e njëri-tjetrit dhe pranimin e larmisë, e cila është parakusht i domosdoshëm për kohezionin shoqëror dhe shoqërinë qytetare pa diskriminim dhe distanca etnike.

Gjegjësisht, të gjitha strategjitë dhe ligjet shtetërore, trajnimet dhe fushatat, të organizuara nga organet shtetërore dhe organizatat joqeveritare - marrin kuptim të plotë me tekste të tilla, në të cilat gazetarë, akademikë, përfaqësues të kulturës dhe aktivistë civilë shpjegojnë trashëgiminë kulturore të bashkësive të tyre etnike, duke deklaruar arsyet e shqetësimeve në lidhje me ruajtjen e tyre.

Në këtë mënyrë, ne duam të stimulojmë dialogun publik për këto tema, përmes shembujve konkretë të dhënë në tekste, duke shpresuar që secili lexues përfundimisht të rrisë nivelin e të kuptuarit të kulturave tjera në Malin e Zi. Si dhe të dëshirojë të mësojë edhe më shumë dhe ta pranojë diversitetin si pjesën më të vlefshme të shoqërisë sonë.

Jelena Ristoviq

Gjuha, kultura dhe zakonet e shqiptarëve në Malin e Zi

Lufta për mbijetesë

Shkruan: Ismet Kallaba

Ismet Kallaba është gazetar i “Koha javore”, revistës së vetme javore në gjuhën shqipe në Malin e Zi. Ai është po ashtu kryetar i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve “Art Club” nga Ulqini. Ka vijuar Shkollën e Menaxhimit Demokratik si pjesëtar i gjeneratës së shtatë.



Gjuha, kultura dhe zakonet janë ndër elementet kryesore të identitetit kombëtar të një populli, të lidhura ngusht me njëra-tjetrën. Ato janë formësuar ndër shekuj dhe përcillen nga brezi në brez si një pasuri kombëtare. Ruajtja e kësaj pasurie është me rëndësi për vazhdimësinë dhe të ardhmen e një populli.

Duke bërë jetë të ndarë nga shteti amë, identiteti kombëtar i pakicave kombëtare është i rrezikuar. Për këtë arsye, në vendet me demokraci të zhvilluar shteti ndërmerr masa me qëllim të mbrojtjes së identitetit të pakicave. Ndërkaq, në vendet me demokraci të pakonsoliduar, siç është Mali i Zi, të drejtat e pakicave maten me numra, domethënë me përqindjen e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë së vendit.

Mali i Zi është shtet shumëncional, shumëgjuhësor, multikulturor dhe multikonfesional, ku zyrtarisht nuk ka popull shumicë dhe ku jetojnë pakica të ndryshme. Shqiptarët janë pakicë kombëtare e veçantë pasi që dallojnë dukshëm nga popujt e tjerë. Sipas regjistrimit të fundit (2011), në Malin e Zi jetojnë 4.91 për qind shqiptarë. Përqindja e shqiptarëve në popullsinë e përgjithshme të Malit të Zi ka ardhur duke u tkurrur nga njëri regjistrim në tjetrin, gjë që flet për fenomenin e asimilimit të tyre të heshtur. Shqiptarët në Malin e Zi jetojnë në trevat që shtrihen në kufi me Shqipërinë dhe Kosovën. Ato sot jetojnë në gjashtë komuna, ku vetëm në dy prej tyre janë shumicë (Ulqin dhe Tuz), kurse në komunat e tjera (Tivar, Guci, Plavë dhe Rozhajë) janë pakicë. Shqiptarët në Malin e Zi bëjnë sot jetë të dyfishtë – ata janë pjesë e shtetit të Malit të Zi, por në të njëjtën kohë përpigjen t’i rivendosin dhe t’i ruajnë lidhjet me shtetin amë, dikur të ndaluara për shkak të rrethanave historike dhe politike të kohës.

Rrezikimi i gjuhës shqipe

Si gjuhë që i takon trungut indoevropian, gjuha shqipe është monumenti më i rëndësishëm i popullit shqiptar dhe konsiderohet një ndër gjuhët më të hershme në rajon dhe më gjerë. Përdorimi i gjuhës shqipe në Malin e Zi ka probleme të theksuara, që lidhen me trajtimin ligjor të saj, por edhe me përdorimin nga vetë folësit e saj. Si rrjedhojë, gjuha shqipe ka përdorim të kufizuar dhe është gjuhë e rrezikuar.



Në aspektin ligjor, gjuha shqipe nuk ka status të barabartë me gjuhën zyrtare dhe gjuhët e tjera që përdoren në Malin e Zi. Në bazë të Ligjit mbi të drejtat dhe liritë e pakicave, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku shqiptarët përbëjnë shumicë apo janë më shumë se pesë për qind të numrit të banorëve të asaj komune. Por në praktikë, me ndonjë përjashtim, gjuha shqipe nuk ka përdorim institucional. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe nuk nënkupton vetëm shkrimin e emrit dhe mbiemrit, mbishkrimeve etj. në gjuhën shqipe, por edhe komunikimin e gjerë përmes shkresave, kryerjen e procedurave administrative etj. Një pjesë të mirë të fajit e kanë vetë shqiptarët, sepse duke qenë se nuk e zotërojnë mirë gjuhën standarde shqipe, sidomos ata që nuk janë shkolluar në gjuhën amtare, e ndërrojnë lehtë kodin e komunikimit. Është absurde që vetë shqiptarët, ta zëmë në Komunën e Ulqinit si komunë ku shqiptarët janë shumicë, komunikojnë ndërmjet tyre zyrtarisht në gjuhën zyrtare, por jo në gjuhën amtare shqipe.

Arsimi është fusha kryesore e përdorimit institucional të gjuhës shqipe në Malin e Zi. Nxënësit shqiptarë kanë mundësi të vijnë shkollimin fillor dhe të mesëm në gjuhën amtare, kurse në nivelin e shkollimit superior ekziston vetëm Programi studimor për përgatitjen e mësuesve në gjuhën shqipe. Prandaj ata që dëshirojnë t'i ndjekin studimet në gjuhën amtare janë të detyruar t'i vijnë studimet jashtë Malit të Zi. Por edhe këtu vërehet prirja e një pjese të shqiptarëve për t'u shkolluar në gjuhën zyrtare për shkak të barrierave që ekzistojnë në rastin e punësimit, për shkak të kryerjes së shkollimit dhe studimeve në gjuhën shqipe. Ky është një ndër faktorët kryesorë pse një pjesë e shqiptarëve orientohen për t'u

shkolluar në gjuhën zyrtare malazeze.

Treguesit konkretë mbi përdorimin e gjuhës shqipe në terren tregojnë se ajo është e kufizuar në mjediset urbane, sidomos në ato mjedise ku shqiptarët nuk përbëjnë shumicë (Tivar, Guci, Plavë dhe Rozhajë), ndërsa gjen hapësira të lira në mjediset rurale, por edhe këtu e ka fushëveprimin të kufizuar. Një fenomen të tillë, albanologët e cilësojnë si ruralizim të gjuhës shqipe. Si rrjedhim i gjithë kësaj, kemi tkurje të numrit të përdoruesve të gjuhës shqipe në Malin e Zi.

Deri tani shteti ka treguar mungesë të përkujdesjes institucionale ndaj gjuhës shqipe. Nuk ka politika gjuhësore dhe nuk ekziston një institucion që merret me gjuhën shqipe dhe mbrojtjen e saj. Në rrethana të tilla të rrezikimit real të gjuhës shqipe, është e domosdoshme që shteti të ndërmarrë masa stimuluese dhe të krijojë mekanizma mbrojtës për rritjen e nivelit të përdorimit të gjuhës shqipe, në të folur dhe në të shkruar, në mjediset private dhe publike. Një detyrim i tillë rrjedh edhe nga Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare. Kjo gjë vlen jo vetëm për Malin e Zi, por edhe për Shqipërinë dhe Kosovën të cilat duhen të ofrojnë mbështetje më të madhe.



Manifestimi letrarë "Kalimera poetike 2015." (Arkivi i Shoqatës së artistëve dhe intelektualëve "Art Club")

Kultura shqiptare, e marginalizuar dhe e anatemuar

Kultura shqiptare në Malin e Zi është pjesë e pandarë e kulturës shqiptare në përgjithësi, por në të njëjtën kohë është pjesë dhe pasuron peizazhin kulturor të Malit të Zi.

Në mungesë të një politike kulturore dhe organizimi të mirëfilltë institucional, kultura shqiptare në Malin e Zi zhvillohet në mënyrë stihike. Në Malin e Zi nuk ka institucione kulturore që merren enkas me kulturën e shqiptarëve, kurse institucionet kulturore në nivel

lokal, që janë bartës të veprimtarisë kulturore në komunat që jetojnë shqiptarët, nuk funksionojnë siç duhet apo vuajnë nga problemet financiare etj. Një ndihmesë të rëndësishme në këtë drejtim, gjatë periudhës së pluralizmit, kanë dhënë sidomos individët dhe shoqatat e ndryshme që merren me artin dhe kulturën shqiptare, por veprimtaria e tyre lidhet kryekëput me mbështetjen financiare për projektet e tyre. Mali i Zi ka krijuar disa institucione që mbështesin kulturën e pakicave, pra edhe të shqiptarëve, siç janë CEKUM dhe Fondi për Pakica, por këto nuk janë të mjaftueshme. Kultura shqiptare si kulturë e një populli pakicë ka problem të mbijetojë, prandaj ka nevojë për më tepër mbështetje financiare, nga institucionet shtetërore dhe komunale, gjë që për momentin nuk ndodh. Dihet se kultura, me ndonjë përjashtim, nuk është veprimtari fitimprurëse, por duhet të subvencionohet, sepse ajo është ushqim shpirtëror për publikun, kurse krijuesit e saj janë përfaqësuesit më të mirë dhe më të denjë të një populli.

Ekzistenca e shumë kulturave është një pasuri e madhe për Malin e Zi. Por në realitet, kultura shqiptare nuk ka trajtim të barabartë. Ajo shihet si një kulturë inferiore në krahasim me kulturën dominuese të shumicës, rrjedhimisht është e marginalizuar dhe e anatemuar. Si pasojë e një qëndrimi të tillë, mund të flitet bile për getoizimin e kulturës shqiptare. Janë të kuptueshme barrierat që vijnë për shkak të gjuhës, por ka mjaft forma të artit dhe të kulturës ku barrierat gjuhësore nuk paraqesin problem, aq më tepër në kohën e sotme të zhvillimit teknologjik. Fajtorë për këtë situatë janë të dyja palët: institucionet kulturore shtetërore, të cilat nuk kanë zhvilluar një politikë të hapur dhe afërmimit ndaj kulturës shqiptare, por nga ana tjetër edhe vetë bartësit e kulturës shqiptare të cilët duhen të bëjnë më shumë përpjekje për t'u integruar në kulturën që krijohet dhe kultivohet në Malin e Zi.

Deri vonë ka ekzistuar perceptimi i gabuar për kulturën shqiptare në Malin e Zi, duke e identifikuar atë vetëm me veprimtarinë e grupeve folklorike dhe veprimtarinë e shoqatave kulturore-artistike. Pa mohuar rolin dhe rëndësinë e tyre, sidomos në ruajtjen dhe kultivimin e këngës së vjetër dhe folklorit, kultura shqiptare në Malin e Zi shquhet për diversitet të krijimtarisë në fusha të ndryshme, si arti, letërsia, filmi, teatri, muzika klasike etj. Mjafton të përmendim emrat e Esad Mekulit, piktorëve Gjellosh Gjokajt e Gjergj Noc Martinit, shkrimtarëve Rexhep Qosja, Hajro Ulqinaku, Mehmet Kraja e Basri Çapriqi, regjisorit Husejin – Bato Dukaj e shumë të tjerëve, një pjesë e të cilëve veprimtarinë e tyre e kanë zhvilluar jashtë Malit të Zi pikërisht për faktin e mungesës së hapësirës krijuese. Po ashtu duhet pranuar se janë krijuar disa veprimtari kulturore me traditë, siç janë Festivali “Skena Verore”, manifestimi letrar “Kalimera Poetike”, Panairi i Librit në Ulqin etj., të njohura jo vetëm për punonjësit kulturorë dhe publikun në Mal të Zi, por edhe më gjerë.

Tabela në qendër të Ulqinit, zbatimi i dygjuhësisë në Ulqin. Autor Ismet Kallaba



Zakonet që dalëngadalë po vdesin

Duke qenë se kanë jetuar bashkë apo në fqinjësi me njëri-tjetrin, shumë zakone dhe tradita të shqiptarëve janë të ngjashme me ato të popullit malazez dhe të popujve të tjerë që jetojnë në Malin e Zi. Ato janë trashëguar brez pas brezi, duke u ruajtur me fanatizëm pothuajse deri në ditët e sotme. Besa vlerësohet si një prej zakoneve unike të shqiptarëve, që nuk haset te popujt e tjerë. Shqiptarët janë të njohur edhe për mikpritjen e tyre. Por sot, nën efektet e globalizmit, zhvillimeve teknologjike dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës, shumë prej këtyre zakoneve kanë humbur apo janë në rrugën drejt humbjes, duke vdekur dalëngadalë dhe mbetur vetëm si relike të së kaluarës. Ato mund t'i hasim vetëm në ceremonitë e dasmës, vdekjes, lindjes etj. Është e kuptueshme se në kohën në të cilën jetojmë, kur jeta po bëhet gjithnjë e më individuale, krijohen zakone të reja të cilat ua zënë vendin atyre të vjetra. Por zakonet duhet të ruhen, sepse janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore dhe materiale të shqiptarëve.

Roli dhe kontributi i shoqatave të ndryshme kulturore-artistike është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e traditave dhe këtyre vlerave të krijuara ndër vite. Me këtë qëllim organizohen edhe disa manifestime kulturore. Po ashtu, krahas muzeve publikë kemi edhe shembujt e mirë të ngritjes së muzeve etnografikë private, siç janë ato në Lekaj të Malësisë, Vuthaj të Gucisë dhe Draginë të Ulqinit, ku gjeneratat e reja kanë mundësi të njihen me të kaluarën dhe zakonet e paraardhësve. Por

këto iniciativa private, sado të rëndësishme për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, nuk kanë mbështetje institucionale nga qeveria dhe komunat ku ekzistojnë.

Si përfundim, duhet thënë se statusi dhe pozita e gjuhës dhe kulturës shqipe në Malin e Zi nuk është e favorshme. Gjuha, kultura dhe zakonet e shqiptarëve në Malin e Zi reflektojnë pozitën e gjithëmbarshme të popullit shqiptar në këtë vend. Shteti duhet të ruajë dhe të kultivojë veçoritë e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Është e vërtetë që Mali i Zi ka krijuar disa institucione që mbështesin dhe financojnë projektet që lidhen me gjuhën, kulturën, traditat dhe zakonet e pakicave, domethënë edhe të shqiptarëve, por kjo nuk është e mjaftueshme.

Por ka një qasje të gabuar edhe nga vetë shqiptarët sa i përket gjuhës, kulturës dhe zakoneve, të cilat trajtohen si diçka me më pak rëndësi në krahasim me disa fusha të tjera si politika dhe ekonomia, ndërkohë që ato janë elementet kryesore të identitetit të tyre kombëtar dhe mbijetesës në këto treva. Nëse nuk flitet hapur për probleme të tilla, nesër mund të jetë vonë, sepse procesi i asimilimit të heshtur të shqiptarëve vazhdon pa ndalur.

Burime:

- Haxhi Shabani, Rrezikimi i gjuhës shqipe - Për dygjuhësinë te shqiptarët e Ulqinit, Toena, Tiranë, 2007.
- Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare
- Ligji mbi të drejtat dhe liritë e pakicave
- Popis stanovništva, domaćinstva i stanova 2011. godine, Uprava za statistiku Crne Gore, Podgorica, 2011.

Gjuha, kultura dhe zakonet e boshnjakëve në Malin e Zi

Diversiteti dhe veçantia, pjesë e mozaikut unik

Shkruan: Edin Smailoviq

Edin Smailoviq lindi në Bijelo Polje në vitin 1980. Shkollën fillore dhe shkollën e mesme e kreu në Bijelo Polje. Ka diplomuar në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, grupi i historisë, në 2005. Që nga viti 2007, ai është punësuar në Qendrën për Kulturë në Bijelo Polje, në pozicionin e shefit të Bibliotekës Kombëtare Bijelo Polje. Deri më tani, ai ka botuar një përmbledhje me poezi “Kalimi” dhe një monografi “Myftitë e Bijelo Poljes”. Ai mori pjesë në konferenca të shumta profesionale dhe shkencore, si dhe ngjarje kulturore në vend dhe jashtë tij.



Mali i Zi është shtet, por objektivisht, madhësia dhe popullsia e bëjnë mikro-rajon. Një numër relativisht i madh i grupeve të ndryshme etnike dhe fetare ekzistojnë në një hapësirë të vogël. Unë jam pjesë e atyre që mendojnë se kjo larmi është bekimi ynë i madh dhe se e ardhmja do ta konfirmojë këtë. Bashkëjetesa është fjalë që nuk më pëlqen. Më mire do thoja, jetë e përbashkët, sepse në të vërtetë jetojmë së bashku, kështu që parashtesa më duket e vrazhdë dhe e panatyrshme. Boshnjakët në Mal të Zi ndajnë hapësirën e tyre të jetesës së bashku me malazezët, serbët, kroatët, shqiptarët, romët. Kur bëhet fjalë për kulturën, zakonet dhe gjuhën, temat e përfshira në këtë botim janë diçka për të cilën mund të shkruhet gjerësisht, por për këtë rast unë kam zgjedhur të merrem me këto tema nga një perspektivë shumë personale. Gjegjësisht, unë jetoj në Bijello Polje, ku kam kaluar pjesën më të madhe të jetës sime deri më tani.

Një pjesë të jetës sime e kam kaluar jashtë kufijve të Malit të Zi, që, besoj, përveç arsimit dhe punës që bëj, më dha një pasqyrë më të mirë të realitetit tonë kur bëhet fjalë për bashkëjetesën.

Fatkeqësisht, çështjet e tilla si gjuha janë kryesisht objekt i përdorimit për agjenda politike ose më mirë keqpërdorimit dhe shpesh përdoren në fushata zgjedhore dhe në kalkulime të ndryshme politike. Malazezët, serbët dhe romët jetojnë në lagjen time. Që nga fëmijëria di çfarë janë Krishtlindjet dhe Pashkët. Unë gjithashtu di për Ditën e Shën Gjergjit, kur fqinjët më të lumtur do ishin romët. Jetojmë në kohën kur konceptet si kultura, zakonet dhe gjuha janë subjekt i politizimit dhe manipulimit. Kohëve të fundit, për fat të keq, edhe temë e caktuar e projekteve me standarde të diskutueshme profesionale. Për t'ia qartësuar më mirë lexuesit, situatën në këto fusha e ndava në segmente.

Kultura

Populli boshnjak në Mal të Zi ka ndërtuar identitetin e tij të veçantë kombëtar, një nga bazat e të cilit është sigurisht kultura. Por kultura nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet si e mbyllur hermetikisht në rrafsh kombëtar ose shtetëror ose në ndonjë kuptim tjetër. Kultura është pasuri shpirtërore, prandaj përhapja e saj te të tjerët është domosdoshmëri, por edhe bukuria e të jetuarit së bashku. Në këtë frymë, ilahitë, kasidet dhe sevdalinkat janë diçka që lidhen me boshnjakët në këtë trevë, por të tjerët gjithashtu kënaqen me to.

Gjithashtu, është e padiskutueshme që Qamil Sijariqi është një nga shkrimtarët më të mëdhenj boshnjakë, por ai është gjithashtu pa diskutim një nga shkrimtarët më të mëdhenj në Malin e Zi. E njëjta gjë vlen për trashëgiminë kulturore të bosh-



*Ndezja e jargavanit -
burimi radio Petnjica*

GJUHA, KULTURA DHE ZAKONET E KOMUNITETEVE ETNIKE NË MALIN E ZI

njakëve në Malin e Zi. Xhamia në Plevla, më e famshmja në Malin e Zi, është pjesë e trashëgimisë kulturore, përkatësisht kulturës së boshnjakëve në Malin e Zi, por është gjithashtu pjesë e trashëgimisë kulturore të Malit të Zi.

Nuk besoj se ka ndonjë që mund të imagjinojë një kartolinë nga Plevla pa këtë bukuri. Pra, kur bëhet fjalë për kulturën, me rëndësi është këndvështrimi i shikimit të saj.

Për këtë, ajo që është në programin arsimor është shumë e rëndësishme, por edhe ajo që po ndodh në procesin arsimor. Shumë e rëndësishme të kuptohet se ajo që kushtimisht u përket të tjerëve është në të vërtetë e jona, sepse hapësira është unike dhe vetëm njerëzit e çmendur mund ta ndajnë atë në këtë mënyrë. Prandaj, kultura e boshnjakëve në Malin e Zi është pjesë e kulturës së shtetit të Malit të Zi. Gjithashtu, kultura e boshnjakëve në Malin e Zi me karakteristikat e saj është pjesë e kulturës së boshnjakëve si popull. Mali i Zi me këtë kuptim të kulturës dhe identiteteve kulturore mund vetëm të përfitojë. Do të duhet shumë punë në fushën e kulturës dhe arsimit që të mbizotërojë ky botëkuptim i kulturës. Unë besoj se kjo pikëpamje e kulturës është mënyrë për të kapërcyer muret etnike dhe fetare në të gjithë rajonin, jo vetëm në Malin e Zi.


Zakonet

Boshnjakët e Malit të Zi u formuan si grup specifik etnik për shkak të rrethave historike. Islami është një nga karakteristikat e pandashme të identitetit të boshnjakëve, por shumë zakone të trashëguara nga periudha paraislame janë bërë pjesë e jetës së përditshme të popullsisë, si dhe zakonet e huazuara nga grupet e tjera etnike me të cilët ndajmë të njëjtën hapësirë për shekuj.

*Xhamia Husein-pashës
Burimi Vikipedija*



*Mevlydi Salih Gasheviqit
burimi Preporod.info*



Gjithashtu, ne nuk duhet të injorojmë faktin se islami të cilin osmanët e sollën në këto treva, e ngjyrosen me shumë tradita paraislamike turke.

Unë jam kufizuar në ato zakone që kanë mbetur në forma dhe emërtime të ndryshme, të përbashkëta për boshnjakët dhe grupet e tjera etnike me të cilët ata e ndajnë këtë hapësirë. Një shembull karakteristik është kremtimi i Aligjunit, në fillim të gushtit. Te krishterët ortodoksë, homologu i kësaj dite është llindani, kurse në fakt të dy grupet festojnë ditën e perëndisë pagane sllave të Perunit, i cili u zëvendësua nga Shën Ilija Gromovnik gjatë krishtërimin. Gjithashtu, ka zakone të tjera të përbashkëta për të gjitha grupet etnike që ekzistojnë në këtë trevë.

Ka zakone që burojnë nga traditat paraislamike dhe parakrishtere, që në disa ditë të mos zhvillohen aktivitete pune, edhe zakone që asnjë lloj pune të mos praktikohet në ditë të caktuara. Festimi i Ditës së Shën Gjergjit është zakon veçanërisht interesant në këtë trevë. Kjo ditë festohet nga të gjitha grupet etnike në Mal të Zi (serbët, malazezët, romët, kroatët etj.). Për shkak të kalendarit Gregorian, katoликët në Mal të Zi e festojnë këtë ditë më 23 prill dhe të tjerët më 6 maj. E vërtetë që kjo nuk është festë e lidhur me traditën krishtere dhe islame, por një ditë që festohej në kohërat antike, dhe ka të bëjë me zgjimin e natyrës, pra fillimin e një cikli të ri të jetës në Tokë.

Gjuha

Gjuha e boshnjakëve në Malin e Zi është gjuha boshnjake. Salih ef. Gasheviq shprehët: “Më luten paria e Kollashinit t’ju shkruaj me vlydin në gjuhën boshnjake”. Unë flas boshnjakisht, por kuptoj shkëlqyeshëm gjuhën serbe, malazeze dhe kroate. Nuk më duhet përkthyesi për asnjë nga këto gjuhë. Mali Zi ka gjetur model të mirë si këto katër gjuhë të mësohen në sistemin arsimor. Po i rikthehem përsëri temës së kulturës. Çdo gjë varet nga këndvështrimi që kemi, a e vendosim në kontekst pozitiv apo negativ. Do ta ilustroj me shembull në vijim. Para pak kohëve, shkolla e gjuhës boshnjake u organizua për fëmijët boshnjakë në diasporë. U shpreha se është projekt i mirë se fëmijët përveç gjuhës boshnjake do të mësojnë gjuhën serbe, malazeze dhe kroate. Në këtë mënyrë do të mund të komunikojnë me 20 milionë njerëz të rajonit. Do lexojnë pa vështirësi Sijariqin, Rebronjën, Selimoviqin, por po ashtu Ratkoviqin, Asanoviqin, Shqeshanoviqin, Kishin, Kërlezhën. Cila hapësirë e ka privilegjin që me mësimin e një gjuhë, të mësoni edhe tri të tjera?

Përfundim

Ne jemi ata që vendosim për politikat kulturore dhe arsimore që do të ndjekim si shtet. Me një politikë të suksesshme kulturore dhe arsimore, theksi i së cilës duhet të jetë gjithmonë në integrimin pa asimilim, kulturat, zakonet dhe gjuha do të jenë vetëm larmi që na bashkon dhe na pasuron, natyrisht.

Por, përveç politikës arsimore dhe kulturore, ndryshimi i qëndrimit të elitave politike është gjithashtu i rëndësishëm. Momenti kur gjuha, kultura dhe zakonet u lihen atyre që janë singërisht të interesuar për të, kur nuk janë pjesë e lojërave politike, kur shpërthimet e shovinizmit dhe racizmit ndëshkohen ashpër, atëherë të gjitha këto çështje mund të trajtohen pa paragjykim.

Frytet e shkëmbit

Shkruan: Vukan Razhnatoviq

Vukan Razhnatoviq lindi në Cetinje, ku kreu arsimin fillor dhe të mesëm. Ai përfundoi studimet e historisë në Fakultetin Filozofik në Nikshiq. Ai përfundoi trajnimin e tij profesional në Universitetin Friedrich Schiller në Jena, Gjermani, në fushën e muzeologjisë. Ai aktualisht është student master në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Malit Zi në degën Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Ai punon si kurator në Muzeun Historik të Muzeut Kombëtar të Malit të Zi.



Jeta e popullit malazez, si e çdo populli tjetër, u formësua nga e kaluara e tij. Periudhat e vazhdueshme të luftës kanë krijuar luftëtarë dhe shoqëri fisnore të dalluar nga populli i vogël malësor, të përfshirë gjithmonë në luftën për ekzistencë, madje edhe në kohë paqeje. Që nga lindja e fëmijës mashkull, shtëpia kishte fituar një pushkë shtesë. Kjo flet për pikëpamjen e jetës si një gjendje e përhershme e luftës. Çdo malazias është mësuar me aftësi luftëtarë që nga fëmijëria e hershme. Në të janë thelluar vlerat e popullit fisnor luftëtar, veprimet e të cilëve ishin kryesisht për të mbrojtur fytyrën e familjes së tyre, fisit, shtetit dhe pastaj gjithçkaje tjetër. Reputacioni ishte më i vlefshëm se jeta. Për këtë dëshmon më së shumti kulti i burrërisë dhe heroizmit, vlerat më të mëdha që ata aspinorin.

Heroizmi ishte në përputhje me natyrën e malazezëve dhe i ndihmoi ata në luftën e vazhdueshme me armiqtë, si dhe në jetën e vështirë në terrenin shkëmbor të Malit të Zi. Mirëpo, me heroizmin vjen krenaria, arroganca, nevoja për të qenë më i mirë se të gjithë të tjerët. Në raste të tilla vlera e burrërisë vinte në pah. Burrëria kishte vlerë më të madhe se trimëria, e këtë e ilustron thënia: “Mijëra trima, e një burrë në ata një mijë” dhe “Trimëri është të mbrosh veten nga të tjerët, kurse burrëri të tjerët nga vetja”. Po ashtu, vlera konsideroheshin modestia, drejtësia, të përmbajturit.


Përveç rolit të luftëtarit, roli më i rëndësishëm i malaziasit ishte të jetë bashkëshort dhe baba, të vazhdojë brezin familjar, që nënkuptonte të mbushet shtëpia me fëmijë meshkuj.

Nga ana tjetër, fëmija femër është konsideruar si “lumturia e huaj” apo “dreka e huaj” dhe është një nga veçoritë kryesore të shoqërisë patriarkale. Rovinski dëshmon se kur malaziasit flisnin për gruan apo vajzën e vet, rregullisht shtonin “më falni”, kurse femrat shpesh shpreheshin „Ruaji Zot vetëm kokat mashkullore“. Nuk ishte e pazakontë të shihet gruaja duke mbajtur ngarkesë të madhe, madje edhe „karvane femrash“. Në anën tjetër, për malaziasin nëna është e shenjtë dhe nuk ka mëkat më të madh sesa mosdëgjueshmëria ndaj nënës. Gruaja e mirë shtëpiake është cilësuar lart dhe ka mbetur thënia lidhur me të (“Nuk qëndron shtëpia në tokë, por në gruan”, “Gruaja është shtylla e shtëpisë” etj). Bashkëshortja

është përzgjedhur jo në bazë të bukurisë apo virtyteve të saj, por në bazë të virtyteve të meshkujve nga ajo shtëpi, nga nami që kishte. Mirëpo, femrat gëzonin disa të drejta në këtë shoqëri patriarkale. Në raste kur bashkëshorti ishte i dhunshëm ndaj gruas, familja e saj kishte të drejtë ta kthejë në shtëpinë e vet, kurse nëse ajo vetë do të vendoste për një hap të tillë, kishte të drejtë të kërkonte pajën e vet.

Këta shembuj na tregojnë se ka ekzistuar raport i dyfishtë ndaj femrave. Në njërin anë, ajo ishte në raport robërie ndaj mashkullit, kurse në anën tjetër mund të ishte shumë e respektuar në shoqëri. Në shoqërinë e sotme, e cila ka pësuar ndryshime të mëdha në shekullin e kaluar, kanë mbetur gjurmët e mentalitetit patriarkal.

Sharl Iriart sipas Valerious, Malazetët shkojnë në pazar në Kotor



Kjo sidomos ka të bëjë me respektimin e zakoneve të shumta në jetën e përditshme apo gjatë ngjarjeve të rëndësishme. Zakonet janë të natyrave të ndryshme, nga traditat pagane të sllavëve të vjetër, si nderja e buzmeve për Krishtlindje, traditave krishtere, në shumicë ortodokse, ku më karakteristike janë festat familjare kishtarë, fenomenit fisnor të gjakmarrjes deri te tradita islame e pirjes së çibukut. Më së shumti në këtë kontekst mbizotërojnë traditat fisnore dhe besimi ortodoks. (Rovinski ka vërejtur se malazezët nuk dinë madje asnjë lutje dhe shtëpia malaziasë në brendësinë e saj nuk ka shenja se banorët e saj janë të krishterë). Malazezët ishin shumë religjioz, në mënyrën e vet, çdokush dinte se për cilët shenjtore mund të punohet apo jo. Ritet kishtarë kanë përcjellur çdo ngjarje të rëndësishme të jetës – lindja, pagëzimi, martesë, vdekja. Kisha ishte i vetmi institucion mbifisnor deri në fund të shekullit 18, përpos Zborit (organi më i lartë drejtues dhe politik në shoqërinë fisnore malaziasë – shënim i përkthyesit), dhe me këtë u bë një ndër faktorët që mund të çrrënjoste anarkinë fisnore dhe të mbante popullin. Mirëpo, as ajo nuk ka mundur ta tejkalojë problemin akut të shoqërisë malaziasë – gjakmarrjen. Sot po ashtu institucionet malaziasë kanë problem me këtë traditë, kurse në popull ka mbetur thënia „Kush nuk hakmerret, nuk shenjtërohet“.

Pjesë përbërëse e kulturës malaziasë është mjekësia popullore dhe bestytia. Edhe sot e kësaj dite, këto bestytia janë të pranishme në popull kundrejt lëvizjeve për emancipim të pjesës së dytë të shekullit 20 dhe fillimit të shekullit 21. “Mbështjellja e kërthizes” për të ndaluar dhimbjen e barkut, ilaçe të ndryshme natyrore të mjekëve popullorë dhe vizita te magjistari „për të hequr magjinë e zezë, janë disa nga format e mënyrave alternative të shërimit (plotësisht bien ndesh me mësimet krishtere), të pranishme te malaziasit. Ndikimet e ndryshme dhe traditat e veçanta përbëjnë amalgamin e kulturës malazeze.



Teodor Valerio, Ruajtësja e armëve, tubes dhe djepit para Manastirit të Cetines

Sidoqoftë, ndikimet nuk hasen vetëm në rit, por edhe në gjuhë. Gjuha malazeze si gjuhë sllave është, natyrisht, e lidhur me gjuhët e tjera të sllavëve të jugut, por gjithashtu ka shumë ndikime nga italishtja, gjermanishtja dhe turqishtja. Ndikimi italian erdhi falë qyteteve bregdetare që kishin qenë nën ndikimin venedikas me shekuj. Fjalët e huazuara janë, ndër të tjera, pamidora, faxhola, polpete, bokal. Gjuha gjermane kishte ndikimin e saj kryesisht gjatë shekullit të 19-të, me fjalë të tilla si granata, howitzers, schritz, hochstapler, leksion... Kjo përkon me kohën kur Monarkia e Habsburgëve u bë fqinji i parë i Malit të Zi të Vjetër. Gjuha turke, natyrshëm, erdhi me pushtimin nga osmanët dhe ndikimi i saj është më i madh në gjuhën malazeze, e cila ka shumë turqizma. Shembuj janë: adet, aga, baba, batanije, çaj, fukara, kafana dhe shumë të tjerë. Për më tepër, duhet të përmendim hungarishten, e cila kishte një ndikim në të gjitha gjuhët e sllavëve të jugut, përfshirë edhe gjuhën malazeze. Sidoqoftë, disa fjalë origjinale për gjërat e përditshme, ato më arkaiket, janë plotësisht të panjohura për banorët e Malit të Zi, të cilët nuk ishin pjesë e shtetit gjatë shekullit të 19-të dhe më herët. Gjuha arriti përdorimin e saj më të gjerë në krijimtarinë popullore në poezinë epike, me temat historike si motivin më të zakonshëm. Prania e vazhdueshme e luftës me këngë i nxiste luftëtarët që mund të ftoheshin nga sunduesi në çdo moment. Një numër më i vogël i përkiste këngëve lirike. Kjo klimë dhe traditë poetike ishte vend ideal të prodhonte arritjet poetike të Njegoshit, peshkopit dhe poetit malazez që e ngriti kulturën malazeze si asnjë individ tjetër, në majat e civilizimit sllav jugor dhe evropian.

Çdo këndim shoqërohet nga një instrument. Kur flasim për muzikën malazeze, në radhë të parë kemi parasysh lahutën, dhe më pak gajdet (instrument frymor), një instrument me një tel të punuar nga qimet e bishtit të kalit, i cili ishte gjithashtu në hark. Lahutat janë një pjesë e domosdoshme e kulturës malazeze, dhe këndimi me ta shërbeu si për argëtim ashtu edhe për edukim. Këngët për betejat u transmetuan atyre dhe u dhanë mësim të rëndësishme për jetën. Lahutarët gëzonin respekt të madh në mesin e njerëzve. Asnjë festival, qoftë i vogël ose i madh, nuk mund të kalonte pa kënduar me lahuta. Lahutat ishin të zbukuruar me motive nga besimet popullore, e kaluara e lavdishme dhe ngjashëm, dhe koka e lahutës zakonisht kishte motive shtazore. Zakonisht ato janë punuar nga një copë druri rrapi (ose halor në mungesë të rrapit, kurrë nga shelgu ose ndonjë lloj druri tjetër i butë), dhe ishin të veshur me lëkurë qengji ose dhie. Tingulli i lahutave përshkruhet si “i mprehtë”, që mund të thuhet për këndimin që shkon me ta. Në të kaluarën, vetëm këngët heroike këndoheshin me tinguj, por deri më sot diapazoni është zgjeruar. Nga këngët e njohura mund të përmendim: “Ndërtimi

i Shkodrës“, “Martesa e Maksim Crnojeviqit“, si dhe këngët për Bajo Pivljaninin, Nikcin nga Rovina, L Lazar Pecirepin dhe hajdutët tjerë. Për dallim nga meshkujt, gratë nuk këndojnë me lahutë, edhe pse dinin shumë këngë heroike. Ato kanë këngët e veta të veçanta – këngët vajtuese që lindin si vuajtje ndaj të afërmeve që vdiqën apo u vranë. Një nga karakteristikat kryesore të kulturës malazeze është kostumi i veçantë. Megjithëse është i ngjashëm me kostumet e rajoneve të tjera të Ballkanit, ai spikat në mesin e tyre. Kjo ngjashmëri u shkaktua nga ndikimi osman në shoqërinë kroate, serbe, bullgare, shqiptare, greke dhe malazeze. Kostumi ishte me ngjyra të gjalla - e kuqe, ngjyrë ari, jeshile, e bardhë dhe e zezë. Përbëhej nga xhamadani, gunjat, jeleku, pullat, “dushanka”, palltoja, “tambulosi”, “silava”, pantallonat, këmisha, këpucët ose çizmet. Kjo i referohet kostumit ceremonial të meshkujve malazias, që ishte punuar kryesisht nga coha. Kostumi i përditshëm zakonisht përbëhej vetëm nga këmisha dhe pantallonat. Pavarësisht a ishte rast solemn apo jo, kapela ishte elementi më i domosdoshëm për malaziasit. Ka disa teori rreth origjinës së formës përfundimtare të kapelës malazeze. Njëra është se ajo u krijua nën ndikimin e veshjes së fesit në Ballkan, me ardhjen e osmanëve. E dyta është se ajo u zhvillua nga një kapelë (vizatimet më të hershme të Njegoshit e tregojnë atë me një kapelë) ose një kapelë e kuqe dalmate. Po ashtu, ekziston teoria se në Mal të Zi kapela erdhi nëpërmjet Pashtroviqëve, nën ndikimin e modës së venedikasve. Kjo kapelë ka fund të rrafshët dhe skaj të rrafshët, e punuar nga pëlhura e kuqe në sipërfaqe me skaj të mbuluar me leckë të zezë. Në sipërfaqe më së shpeshti kishte qëndisje ari me motive të gjysmërrethit, inicialet e pronarit, yllin gjashtërrremësh apo inicialet e sundimtarit malazias. Kapela malazeze ka pasur simbolikë të madhe te malaziasit dhe ka përfaqësuar kokën, pra vetë pronarin. Kështu, në pamundësi për të marrë pjesë në ndonjë akt solemn, malaziasit dërgonte kapelën e vet me dikë dhe kështu konsiderohej se ka marrë pjesë personalisht. Një shembull tjetër është që kapela nuk vendosej kurrë në tavolinë, sepse kjo do të thoshte që pronari i saj aty e gjente dhe ishte zakon që i ndjeri të mbahej në tavolinë pas vdekjes.

Kapela ishte po ashtu pjesë e kostumit popullor të grave, sikur te burrat, shpesh me një shall. Kostumi i grave ishte po aq bujar sa i burrave. Përbëhej nga shumë elemente: elbi, kamizola, faneli, dolama, krunde, fundi, rasa dhe përparësja. Ashtu si tek ai për burra, kishte edhe versione më zyrtare të kostumit, i cili përveç pjesëve më të shtrenjta dhe me cilësi të lartë, por edhe më të pasur të zbukuruar, përmbante edhe bizhuteri të ndryshme, në të cilat mund të shiheshin ndikime orientale. Më karakteristik është çëmeri, një rrip i grave i zbukuruar.

Teodor Valerio, Ruajtësja e armëve, tubes dhe djep-
it para Manastirit të Cetinës



Pasuria e veshjes malazeze ishte krejt e kundërta me shtëpinë malaziasë. Në shtëpi, gjërat më të vlefshme ishin vetë kostumi dhe armët, të cilat shpesh ishin pjesë e saj. Brenda kishte gjëra themelore: shtretër, karrige dhe një tavolinë për ngrënie, arka për një numër të vogël rrobash dhe për shtrat, takëm, mjete për bujqësi dhe një fije kali së cilës i kushtohej vëmendje e veçantë në përpunim dhe dekorim. Shtëpia zakonisht përbëhej nga dy pjesë: një pjesë për strehimin e anëtarëve të familjes dhe një vend për bagëtinë (jetesën), e cila quhej tavernë.

Ajo mund të ketë qenë në dhomën tjetër ose në katin e poshtëm të shtëpisë. Qendra fizike dhe shpirtërore e shtëpisë ishte vatra rreth së cilës zhvillohej jeta dhe

simbolizonte familjen ashtu si kapelën e një individi. Nëse ata do të thoshin se vatra nuk ishte ndezur, kjo do të thoshte që shtëpia kishte mbetur pa pasardhës meshkuj, domethënë që ishte rrënuar. Të gjitha traditat, përfshirë ato malazeze, kanë aspektet e tyre pozitive dhe negative. Nuk duhet shmangur prej kësaj ose të kemi turp. E gjitha është një gjë e së kaluarës dhe ajo që na bën shoqëri që jemi sot. Sidoqoftë, ato pozitive duhet të trashëgohen më së shumti për të përmirësuar dhe pasuruar identitetin kulturor kombëtar, ndërsa ato negative duhet të përpiqen të qëndrojnë aty në të kaluarën dhe në librat e historisë. Burrëria dhe trimëria duhet të ruhen plotësisht në shekullin 21, pavarësisht nga fakti se nuk ka kërcënim të vazhdueshëm nga pushtuesit e huaj. Të trashëgohen vlerat familjare siç i kanë trashëguar paraardhësit, por të jenë më të drejta në marrëdhëniet me vajzat dhe gratë. Dhe së fundmi, të pasurohet gjuha me vepra të reja.

Burimet:

- Pavle Rovinski Crna Gora u prošlosti i sadašnjosti tom II i III, Cetinje 1994.
- Adnan Čirgić Natprirodna bića u tradicijskoj kulturi Crnogoraca, Cetinje 2018.
- Adnan Čirgić Antologija crnogorskih usmenih tužbalica, Cetinje 2018.
- Aleksandar Radoman Pregled crnogorske usmene književnosti, Matica 54, Cetinje 2013.
- Saša Brajović Re-prezentacije Crnogoraca Teodora Valerioa, Istorijsku zapisi 1-2, Podgorica 2017.
- Zbornik radova XXXV kongresa Saveza Udruženja folklorista Jugoslavije, Rožaje 26 – 29. Septembar 1988., Titograd 1988.

Gjuha, kultura dhe zakonet e kroatëve në Malin e Zi

FRYTET E DETIT

Shkruan: Marija Saulačiq dhe Martina Saulačiq – Llompar

Marija Saulačiq lindi në Kotor në vitin 1954, ku mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe të mesme. Ajo u diplomua në Fakultetin Filozofik në Zadar në klasën e prof. Stijepa Obada - histori dhe gjuhë ruse (studim me dy lëndë). Ajo mori një diplomë si profesoresh e historisë dhe gjuhës ruse. Ajo punoi për një kohë të shkurtër në Qendrën shkollore Tivat, dhe pastaj për 40 vjet në Institutin Rajonal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Kotor, përkatësisht Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore - Kotor. Ajo ka punuar si profesoreshë, konservator i historisë I. Tash shtatë vjet, së bashku me vajzën, bashkëshortin, ka botuar dy botime "Gjiri i Kotorrit" në një tirazh deri në pesë mijë kopje për botim, të cilat u shpërndahen falas turistëve përmes Organizatës Turistike Kotor dhe Organizatës Turistike Tivat. Botimi prezantoi turistët në monumentet më të rëndësishme kulturore të Gjirit të Kotorrit dhe parqet kombëtare të Malit të Zi. Publikimi i dytë është "Kotoranka", i cili merret me tema lokale.



Martina Saulačiq Llompar lindi në Kotor në vitin 1983, ku mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe të mesme. Ajo u diplomua në Fakultetin Filozofik në Zadar me një studim dy lëndësh dhe mori një diplomë të profesorit të gjuhës dhe letërsisë italiane dhe profesorit të gjuhës dhe letërsisë angleze. Gjatë studimeve të saj, ajo ndoqi Shkollën Verore Green Hill në Londër dhe Shkollën Private Bertrand Russell në Padova. Ajo mori një bursë nga Klubi Rotary në bashkëpunim me Universitetin e Padovës dhe ndoqi leksione në Italisht dhe Anglisht në Itali për dy semestra. Ajo ka licencën turistike dhe ka punuar shumë përkthime. Ajo është e punësuar përgjithmonë në shkollën fillore “Ivo Visin” në Prçanj. Ajo është presidente e OJQ-së “Dante Alighieri” në Kotor dhe themeluese e OJQ-së “Lingua” në Kotor.



Për shtatë vjet, ajo ka qenë kryeredaktore e dy botimeve “Gjiri i Kotorrit” në një tirazh deri në pesë mijë kopje për botim, i cili u është shpërndarë falas turistëve përmes OT Kotor dhe OT Tivat. Botimi prezantoi turistët në monumentet më të rëndësishme kulturore të Gjirit të Kotorrit dhe parqet kombëtare të Malit të Zi. Publikimi i dytë është “Kotoranka”, i cili merret me tema lokale.

Kroatët në Bokën e Kotorrit i kanë rrënjët e thella. Ata mund të gjenden në dokumentet e Arkivit të Ipeshkvisë dhe Arkivit Historik në Kotorr. Kroatët e Bokës kanë ndarë, pak a shumë, të njëjtin fat me pjesën tjetër të Dalmacisë 502 vite të plota (1420-1922) dhe ishin të orientuar kah deti si të vetmin burim të të ardhurave. Në periudhën 1391-1420, Kotorri kishte status të qytet-shtetit të lirë sikur Dubrovniku. Hapësira të mëdha toke për përpunim nuk kishin, kështu që nuk mund të merreshin me bujqësi apo blegtori. Sikur fqinjët e tyre nga Dubrovniku, kroatët e Bokës pasi mësuan se nga toka e vet nuk mund të presin shumë, iu drejtuan detit dhe u morën me detari e tregti. Ata i janë përmbajtur thënies së Plutarkut “Navigare necesse est, vivere non est necesse” (“Të lundrosh është domosdoshmëri, të jetosh jo”).

Kroati i Bokës nuk është vetëm tregtar, por dhe bartës i njohur i vlerave kulturore. Nga shtetet e përparuara, ai sillte në vendin e vet të mira materiale dhe artefakte të ndryshme kulturore, libra, mobilje, piktura artistike dhe të tjera. Popullatë shumicë në këtë periudhë në Bokë ishin kroatët dhe romanët dhe një numër më i vogël i popujve tjerë. Qytetarët ndaheshin në fisnikët e pasur dhe të varfrit. Gjatë tërë historisë, Kotorri dhe e tërë Boka janë mbrojtur me shkathtësi nga pushtuesit, u pasuruan, zhvilluan detarinë, kulturën dhe shkencën. Detarët kroatë të Bokës patën flotë të madhe anijesh në shekujt e kaluar. Lundronin nëpër tërë botën. Me të hollat e fituara nga deti, duke u ballafaquar me stuhi, piratë e kusarë, ndërtonin pallate nëpër Bokë dhe objekte shumë të bukura sakrale. Ata ishin krijues të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, që ndikonte në fuqizimin e tyre ekonomik. Ata po ashtu ishin mbrojtës të trashëgimisë së monumenteve kulturore. E tërë kjo vinte nga frytet e detit.

Çdo gur dëshmon për popullatën autoktone kroate në Bokë. Kultura, tradita dhe besimi janë të njëjtë si në tërë Dalmacinë dhe pjesë të Kroacisë. Duke mbajtur timonin e anijes me vela në një dorë dhe pushkën në dorën tjetër, për t'u mbrojtur nga kusarët e piratët, kroati i Bokës ka lundruar përgjatë Mediteranit dhe ka shkruar shembujt më të ndritshëm të heroizmit të detarit.

Poeti dhe shkrimtari popullor kroat, Atë Andrija Kaçiq Mioshiq (1704-1760), i cili është një nga shkrimtarët më të njohur kroatë, këndon kështu: *“Hej Kotorr, foleja e sokolit/ i vendosur në degën e lartë/, ku shtrihen dragonjtë dhe sokolat,/ të cilët mbretit i kanë dhënë shumë/ përkulur në një bredh të gjelbër/, dhe mbulon Gjirin e Kotorrit/ që është nderi i kroatëve/ dhe zemër kalorësi nga heronjtë”*.

Konti dhe diplomati rus, **Peter Andreyevich Tolstoj** (1645-1729), udhëtoi nëpër Evropë gjatë periudhës 1697-1699, për nevojat e diplomacisë ruse të Pjetrit të Madh. Tolstoj i përmendë kroatët nga Peleshaci në Perast për herë të parë kur rendit anëtarët e kombeve të ndryshme që jetojnë në Venedik. Ata janë të vetmit sllavë që ai vuri re atje dhe ata e quajnë veten kroatë. “Ata nga Peleshaci në Perast të gjithë flasin gjuhën sllave, dhe quhen Gervati (kroatë) dhe ata i përmbahen besimit romak”. Duke mbërritur nga Dubrovniku në Perast, P. A. Tolstoj shkroi se vendi ishte vendosur në shtetin venedikas dhe se “Gervati” (Kroatët) jetojnë aty. Ai thotë se ata janë kapitenë, astronomë dhe detarë, duke krijuar kështu një lidhje me pjesën perëndimore të Republikës së Dubrovnikut, për të cilën ai shkroi derisa ishte në Korçullë. Ai thotë

se ka serbë të besimit grek në Perast, megjithëse atje nuk ka kishë greke. Ai beson se këta serbë në shtetin e Venedikut u larguan kohëve të fundit nga shteti i sulltanit turk. Ata janë ushtarë dhe të gjithë flasin sllavisht, veshin kostume kroate dhe gratë e tyre ngajnë me gratë kroate. Shënimet e Tolstojit për kroatët dhe serbët tregojnë që kroatët në Bokën e Kotorrit janë vendas dhe element mbizotërues si popull. Përveç kroatëve dhe serbëve, Tolstoj po ashtu përmend malazezët si banorë të Bokës, afër Kotorrit dhe Perastit. Në Perast qëndroi te kapedani Vicko Bujeviq, në anijen e të cilit kishte qëndruar Julije Balloviqi. Ai në vitin 1693 shkroi një manual detar, në të cilin ai e quajti gjuhën e tij amtare “Slavo” dhe “Slavo-Ilirico” në italisht, dhe në fjalorin e këtij manuali ai përktheu etnonimin **Slavo** në etnonimin **kroat**. Ai e bëri këtë, sepse venedikasit kroatët dalmatinë rregullisht i quanin sllavë (Sclavo, Schiavone), kurse ata veten e quanin në gjuhën burimore kroatë, sipas etnonimit venedikas që rrjedh nga S(c)lavi. Nga ky libër vërehet qartë që kroatët e quajnë gjuhën e tyre ilire dhe sllovene. Pra, ilirishtja ose sllovenishtja është në të vërtetë gjuha kroate.

Fisniku i Kotorrit, Maro Dragović, në përkushtimin e tij për Bartol Kashiqin, Dalmacinë e konsideron përcaktues më të ngushtë të identitetit, dhe Kroacinë më të gjerë.

Trashëgimia monumentale kulturore e Bokës të Kotorrit është e madhe. 60 për qind e thesareve monumentale të luajtshme dhe të paluajtshme të Malit të Zi ndodhen në qytetin e Kotorrit. Megjithëse kroatët e Bokës janë sot pakicë (afërsisht 7 100 banorë), **në masë të madhe kultivojnë trashëgiminë e madhe kulturore dhe historike**. Në zonën e Bokës të Kotorrit ka një numër të madh të kishave dhe pallateve, me vlera të veçanta kulturore-historike, artistike dhe arkitektonike, të cilat pasurojnë trashëgiminë kulturore të tërë Malit të Zi. Si falënderim për mbrojtje nga rreziqet në det, gjatë lundrimeve të shumta, në emër të Zotit, ata ngritën shumë kisha, manastire, kapela, shkruanin libra dhe i dhuruan pllaka argjendi kishës.

Kishat: Kotorri kishte 33 kisha katolike. Më e vjetra dhe më e rëndësishmja prej tyre është katedralja-bazilika romane-gotike e Shën Tripunit e vitit 1166 dhe pesë kisha romane. Këto janë Kisha Kolegjiale e Shën Mërisë e vitit 1221, Kisha e Shën Anës e shekullit XII, Kisha e Shën Mikaelit nga fundi i shekullit të 13-të, Kisha e Shën Paulit e vitit 1263 dhe Kisha e Shën Lukës e vitit 1195. Në qytet ka një manastir dhe Kisha e Shën Klarës e shekullit XVII, Kisha e Shën Jozefit e vitit 1631 dhe Zojës së Pushimit (Zoja e Shëndetit) e vitit 1518 në kodrën e Shën Ivanit. Është e padiskutueshme që popullsia romane luajti një rol dominant në



Marina e Bokës, autorët e fotografive janë Andro Saulaçiq dhe Martina Saulaçiq Llompar

ndërtimin e këtyre kishave mesjetare, por popullata sllavo-kroate sigurisht që luajti një rol meritator krahas tyre. Kisha të shumta u ndërtuan nga marinarë në të gjithë Bokën, nga Kisha e Nënës së Zotit në Përçanj, Kisha e Shën Mathiasit dhe Shën Stasijs në Dobrotë, Kisha e Shën Mërisë në Stoliv, Kisha e Ndhmës së të Krishterëve (i bekuari Gracia) në Mula, Kisha e Zojës nga Shkëmbinjtë (Gospa od Škrpjela) dhe Shën Gjergjit në dy ishuj përpara Perastit, Kisha e Shën Nikollës në Perast dhe shumë kisha të tjera në Tivat dhe Herceg-Novi. Shumica e këtyre kishave janë ndërtuar me trashëgiminë e kroatëve të Bokës. Arkivat e ipeshvive, biblioteka e manastirit françeskan dhe arkivat e shumë kishave të tjera në të gjithë Bokën ruajnë thesarin kulturor të paprekshëm të kroatëve, i cili është një burim i vërtetë për historianët, etnologët, shkrimtarët dhe studiuesit.

Pallatet: Në zonën e Bokës ka 34 pallate të familjeve detare kroate, kryesisht nga periudha e barokut, të cilat janë dëshmitare të prosperitetit ekonomik, sensit për arkitekturë dhe art, si një lloj veçorish të familjeve të atëhershme detare. Kroatët e Bokës sollën objekte të shtrenjta arti nga udhëtimet e tyre dhe i zbukuruan pallatet

e tyre me ta. Koleksionet etnografike të Muzeut Detar në Kotorr dhe muzeve të tjerë në Bokë, kryesisht u përkisnin familjeve kroate.

Letërsia e Bokës: Letërsisë kroate të Bokës nuk i është përkushtuar mjaft vëmendje, por ajo është bërë pjesë e antologjisë së “barokut dhe klasicizmit” të disa popujve fqinj. Një numër i madh i poetëve dhe shkrimtarëve siç janë Juraj Bizanti (1490-1560), Ludovik Paskaliq (1500-1551), Ivan Bona Boliris (1520-1570), Jeronim Pima (shek. XVII), Andrija Zmajeviq (shek. XVII), Timotej Cizila (shek. XVI), Marko Martinoviq (1663-1716), Vicko Zmajeviq (1670-1745), Julije Baloviq (1672-1727), Krs-to Mazaroviq (1680-1725), Matija Zmajeviq (1680-1735), kanë pasuruar letërsinë e Bokës, të Malit të Zi dhe Kroacisë. Një ndër ta është Ivan Antun Nenadiq (1723-1784), i cili shkroi dy poezi epike, një shumë të njohur. Poezia heroike u shkrua për të nderuar kalorësit Marko dhe Jozo Ivanoviq. Ata u shënuan në histori si luftëtarë ndaj kusarëve të rrezikshëm. Sidomos, fitorja e tyre ndaj kusarëve të fuqishëm turk tek Athina në vitin 1756. Me sugjerim të senatit, doxhi venedikas e dekoroi Jozo Ivanoviqin me dekoratën më të lartë të Republikës së Venedikut, duke e emëruar atë një kalorës të Shën Markut, kurse para kësaj me të njëjtin titull u dekorua Marko Ivanoviqi në vitin 1751.

Nuk mund të mos përmendim marinarët e famshëm të Bokës: komandantin e galerës Jeronim Bizanti (-1571), heroi i Betejës së Lepantos, Marko Martinoviq (1663-1716), një kapiten dhe matematikan i marinës që i dha mësim 17 kadetëve rusë të Mbretit Pjetrit të Madh; Matija Zmajeviq (1680-1753) admiral rus, Ivo Vizin (1806-1869) i cili e përshkoi botën si marinar. Boka gjithashtu kishte shumë piktorë të famshëm: kroat i Lovro Marinov Dobriçeviq (Kotorr, -1478), i cili pikturoi në Kotorr dhe Dubrovnik, piktori kroat i barokut të vonshëm Trip Kokolja (1661-1713), i cili pikturoi Zojën e Shkëmbinjve në Perast dhe shumë të tjerë.

Veshja e grave - Gratë kroate në Bokën e Kotorrit kanë përdorur kostume tradicionale sipas traditës që nga shekulli i 16-të. Kjo veshje është quajtur dobrotsko (e Dobrotit) që nga fillimi i saj, por ajo është veshur gjithashtu në Kotorr, Shkaljari, Mullo dhe Përçanj. Ajo u quajt dobrotsko, sepse u përdor për herë të parë në këtë vend të pasur detar. Ajo ishte më e bukura dhe më e pasura në të gjithë Bokën. Nga atje u transferua në Gornja Llastva, Tivat dhe Donja Llastva dhe njihet si kostumi i Llastovës. Kostumet më së shumti i kanë punuar gratë në shtëpitë e tyre, rrobaqepësit në Kotorr, kurse marinarët më të pasur i punonin në Venedik.

Zakonet më të rëndësishme tradicionale:

Festa e Shën Tripunit së bashku me lojën e valles e cila luhet për nder të tij para Katedrales në Kotorr, ku merr pjesë edhe forca detare e Bokës (“Marina e Bokës”) është solemnitet qendror dhe karakteristik i traditës së kroatëve të Bokës, kudo që ndodhen në botë, dhe u përket të gjithë të tjerëve të cilët i bashkëngjiten, e respektojnë dhe e kultivojnë këtë traditë, pavarësisht nga feja dhe kombësia, që është një nder i madh për të gjithë bokelët. Këtë traditë në gjithë botën e kultivojnë bokelët në Kroaci (Split 150 vjet), Zagreb (100 vjet), Rijekë, Pulë dhe Dubrovnik.

Banorët e Kotorrit në shekullin IX, më saktësisht më 13. 01. 809, e kanë shpague fuqinë e Shën Tripunit nga detarët e Venedikut të cilët gjatë lundrimit të tyre nga Konstantinopoja në Venedik i ndaloi stuhia në hyrje të Bokës. Sipas traditës, kur anija me fuqitë e shenjtorit arriti në Kotorr, marinarët (detarët) luajtën një valle për nder të tij, kështu që supozohet se në atë kohë kishte forca detare (marinë) të organizuara në Kotorr, si dhe në pjesën tjetër të bregdetit.

Prandaj, kjo datë konsiderohet si hera e parë që përmendet ekzistenca e forces detare (marinës) së organizuar në Kotorr, e cila operon vazhdimisht deri më sot. Që nga hera e parë që përmendet në arkiv në vitin 1363. Si një „Shoqëri e devotshme e marinarëve të Kotorrit“, përmes Statutit të parë të ruajtur nga viti 1463 (Statuti i Vëllazërisë së Shën Nikollës, marinar në Kotorr), kjo ishte një organizatë e fuqishme humanitare dhe ushtarake, ekonomiksht e fuqishme dhe e lidhur me festimin e Shën Tripunit. Që nga viti 1859 i humbë të gjitha funksionet e mëparshme dhe deri më sot i mbetet vetëm pjesëmarrja në festimin e Shën Tripunit, mbrojtësit të qytetit.

Festa e Shën Tripunit fillon më 27 janar, me paralajmërimin e ceremonisë kryesore nga „admirali i vogël“, i cili reciton lode (lavdërime) për nder të Shën Tripunit. Në atë ditë, për



Veshja e Bokës, autorët e fotografive janë Andro Saulaçi dhe Martina Saulaçi Llompar

më shumë se 500 vite, forca detare (marina) e Bokës mernte pushtetin ekzekutiv në qytet (çelësat e qytetit, burgut, stemën dhe flamujt e qytetit), të drejtën për të dhënë azil dhe të drejtën për falje, gjatë tri ditëve para dhe pas ditës së Tripunit. Këto autorizime (të drejta) u shfuqizuan nga rënia e Venedikut dhe sot dorëzimi simbolik i çelësave të qytetit dhe flamurit bëhet në 21 nëntor në Ditën e Çlirimit të qytetit në vitin 1944. Festimet vazhdojnë më 2 mars, me një mbrëmje solemne në Katedralen e Shën Tripunit në Kotorr, me temjanin e shenjtorit në altarin kryesor në të cilin marrin pjesë gjashtë qytetarë të shquar katolikë dhe gjithashtu gjashtë ortodoksë të shquar. Kjo është një traditë unike në të gjithë botën.

Në ditën e Shën Tripunit, më 3 shkurt, festa fillon me lojën e valles, me kërkesën para-prake të lejes nga udhëheqësi i valles dhe me dhënien e pëlqimit dhe bekimit nga ana e peshkopit (vitet e fundit në javën e parë pas 3 shkurtit). Vallja me figura të njohura dhe e shoqëruar nga muzika e qytetit luhet për nder të mbrojtësit qiellor Shën Tripunit, në orën 10.00, para Katedrales. Pastaj ndiqet nga mesha e shenjtë dhe në orën 12.00 një riti ceremonial nëpër qytet me fuqitë e Shën Tripunit dhe shenjtorëve të tjerë, me pjesëmarrjen e forcës detare (marinës) të Bokës, Muzikës së Qytetit, klerikëve, besimtarëve dhe admiruesve të kësaj tradite.

Forca detare (marina) e Bokës në krye me admiralin, nënadmiralin, admiralin e vogël, ndihmësit, kapitenët, togerët dhe marinarët, vesh uniformën tradicionale gjatë festave.

Fashinada - Kisha e Zojës së Shkëmbinje (Gospa od Škrpjela), e cila u ndërtua në një shkëmb falë procesit të fundosjes së anijeve të mbushura me gurë për shumë vite me radhë me qëllim që të ndërtohej një ishull, është tempulli më i bukur marinar i kishës së kroatëve. Edhe sot, ishulli mirëmbahet në një mënyrë të tillë që çdo vit, më 22 korrik, varkat plot me gurë lundrojnë sipas ritit nga Perasti deri tek ishulli dhe duke kënduar këngë popullore hedhin gurë rreth ishullit. Ky zakon tradicional quhet „fashinada“. Koleksioni më i madh i pllakave dhiatore „ex voto“ ndodhet në ishullin e Zojës së Shkëmbinje (Gospa od Škrpjela) dhe ato dëshmojnë për krishterimin shekullor të ngulitur në jetën e kroatëve të Bokës.

Dita e Besëlidhjes dhe goditja e gjelave është një nga zakonet tradicionale që mbahet çdo vit më 15 maj në Perast, si pjesë e fitores së lavdishme të një numri të vogël të banorëve të Perastit mbi ushtrinë turke (gjeli simbolizon një turk). Ushtria e fuqishme turke e sulmoi Perastin më 15 maj të vitit 1654 nga drejtimi i Risanit dhe numëronte rreth pesë mijë

ushtarë, të udhëhequr nga dizdari i Risanit, Mehmed agë Rizvanagiq. Banorët e Perastit ishin „një grusht“, qindra mbrojtës të guximshëm të Perastit. Për turqit, Perasti si vend kristian-katolik ishte posaçërisht një gjembë në këmbë, sepse njerëzit e Perastit ishin të fuqishëm si në det ashtu edhe në tokë. Ata ishin detarë të aftë dhe luftëtarë të guximshëm. Banorët e Perastit ia atribuan dhe kushtuan suksesin e tyre të madh në luftën e pabarabartë ndihmës së fituar nga Zoja e Bekuar Virgjëresha Mari, mbrojtëses së tyre, ikonën (imazhin) e së cilës ata e zhvendosën para betejës nga ishulli i Zojës së Shkëmbinjtë në fortesën e Kryqit të Shenjtë dhe kërkuar ndërmjetësimin e saj te Zoti. Populli i Perastit gjithashtu e quajti fitoren e tyre „fitore e Nënës së Zotit“. Që prej atëherë, ata janë zotuar të festojnë kujtimin e kësaj fitoreje të lavdishme çdo vit me meshën e shenjtë dhe një rit rreth qytetit me imazhin e Zojës. Tetë ditë pas betejës së Perastit, heronjtë u nderuan me ardhjen e Kontit Petar Zrinski (1621-1671), një dukë kroat, udhëheqës ushtarak dhe poet. Ai ishte stërnipi i të famshmit Nikolla Shubiq Zrinjski, hero i Sigetit, i cili u quajt „mburoja e krishterimit dhe dordoleci (gogoli) i turqve“. Duke vizituar „Perastin e lavdishëm, të lumtur dhe fisnik“, ai iu dhuroi heronjtë një shpatë, e cila mbahet gjatë ritit që kryhet më 15 maj për çdo vit.

Nata e Bokelëve - ose „festa mbi të gjithë festat“, e modeluar sipas Natës së Venedikut, mbahet çdo vit në fund të gushtit. Anije me zbukurime lundrojnë gjirin përpara portit të qytetit të ndriçuar, me muzikë dhe me mijëra vizitorë që i shikojnë të gjitha nga bregu i qytetit. Së bashku me kroatët, festimet u pranuan nga banorët tjerë të Gjirit të Kotorrit. Karnavalet mbahen në Kotorr, Përçanj dhe Llastovo.

Çdo vit mbahet një karneval dimëror që karakterizohet me djegien e fajtorit kryesor për „vitin e kaluar“. Ai mbahet javën e fundit para Kreshmës Katolike. Karnevali veror mbahet në fillim të gushtit të çdo viti, me pjesëmarrjen e grupeve të karnavaleve vendas dhe të huaj. Së bashku me kroatët, festimet u pranuan nga banorët tjerë të Gjirit të Kotorrit.

Zakonet e kroatëve lidhur me festimin e festave më të famshme katolike në Gjirin e Kotorrit janë: Festa e Shën Tripunit, më 3 shkurt në Kotorr; Ozana e Bekuar në Kotorr, më 27 prill; Festa e Shën Leopold Bogdan Mandiq në Herceg-Novi, më 12 maj; Dita e besëlidhjes për nder të Zojës, më 15 maj në Perast; Festa e Zojës së Madhe, e cila festohet në ishullin e Zojës së Shkëmbinjtë (Gospa od Škrpjela) në Perast, më 15 gusht; Festa e Zojës së Vogël në Përçanj, më 8 shtator; Gracia e Bekuar, më 8 nëntor në Muo pranë Kotorrit; Festa e Zojës së Shëndetit në Kotorr, më 21 nëntor.

Besimi i fortë i kroatëve të Bokës lindi një mori të të adhuruarve të Zotit. Boka është vend-lindja e Shën Leopold Bogdan Mandiq, Gracias së Bekuar nga Mula, Shërbëtores së Zotit Ana Marija Maroviq, dëshmorëve të Bokës: dy Fr. Marin nga Kotorri, Pjetri, Lovro dhe Andrija, prandaj Boka quhet gjithashtu edhe „Gjiri i Shenjtorëve Kroatë“. Mbi të gjithë qëndron shpirti i shenjtit mbrojtës qiellor Shën Tripunit dhe i së bekuares Ozana nga Kotorri (malaziase nga Relez afër Cetinës), mbrojtëses ekumenike të Metropolisë së Splitit, e cila përfshin gjithashtu Dioqezën e Kotorrit.

Gjuha - Përveç emërtimit kombëtar, kroatët në Bokë kishin edhe një karakteristikë tjetër kombëtare, gjuhën. Gjatë Republikës së Venedikut, gjuhë zyrtare ishte italishtja, por kishte përkthyes në kroatisht. Në atë periudhë, popullsia kroate përveç fjalëve kroate përdorte edhe fjalët romake (romanizmat). Kjo nuk ndryshoi as pas rënies së Venedikut, as gjatë okupimit të shkurtër të Austrisë deri në Kongresin e Vjenës në vitin 1814, si dhe as gjatë pushtimit afatshkurtër të Gjirit të Kotorrit nga Franca, ashtu edhe as gjatë okupimit njëqindvjeçar të Austrisë (më vonë Monarkisë Austro-Hungareze), e cila futi në përdorim zyrtar gjuhën letrare italiane. Romanizmat kanë mbijetuar deri më sot. Pasi që e gjithë Dalmacia, pjesë e së cilës deri në vitin 1922 ishte edhe Boka, nga viti 1420 deri në vitin 1797 ishte nën sundimin e Venedikut, shumica e fjalëve me origjinë romake janë huazuar nga dialekti italian apo venediko-italian. Disa fjalë romake (romantizma) janë: „abrum“, „ballancana“, „borsha“, „qakula“, „çipula“, „feshta“, „fjaka“, „gunj“, „kanavaca“, „kapot“, „kashtradina“, „llesho“, „llencuo“, „llincura“, „macolla“, „pitura“, „pjaca“, „shkat-ulla“, „shkoranca“, „shtramac“, „takuin“, „tavaja“, etj.

Roli i mediave është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tolerancës, nxitjen e mirëkuptimit dhe jetës harmonike midis komuniteteve të ndryshme etnike në Mal të Zi, si një shtet shumëetnik dhe shumëkonfesional. Në rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbi pakicat etnike dhe mediat të vitit 1995, ndër të tjera, thuhet: „Mbulimi mediatik i përmbajtjeve në lidhje me pakicat etnike ka një ndikim të madh pozitiv në opinionin publik“. Respekti për secilin komunitet etnik dhe fetar, në vend të ekskluzivitetit dhe shkrirjes së diversitetit, mund të çojë tek përparimi për të gjithë. Komunitetet e ndryshme etnike dhe fetare janë si gishtat e dorës, të cilat krijojnë harmoninë dhe funksionalitetin e dorës. Pa njëri-tjetrin nuk mund të krijojmë një jetë harmonike për lumturinë dhe kënaqësinë e të gjithëve.

Gjuha, kultura dhe zakonet e myslimanëve në Malin e Zi

Mërkoti, perla e pahulumtuar

Shkruan: Sabrija Vuliq

Sabrija Vuliq u diplomua nga Fakulteti i Turizmit dhe Hotelieris në Kotor. Ai ka një diplomë master nga Fakulteti i Arteve Dramatike në Cetinë. Ai filloi karrierën e tij gazetare në 1989 në Radio Kotor. Ai ka punuar në TV Sky Sat, RTV Atlas dhe shumë media të tjera dhe aktualisht është i punësuar si redaktor i Programit të Dytë të TVCG. Gjatë karrierës së tij ai ishte korrespondent për shumë media vendase dhe ndërkombëtare. Ai ka marrë vlerësime të shumta për punën e tij. Ai është President i Këshillit të Popullit Mysliman të Malit të Zi. Baba i katër fëmijëve.



Në qoftë se pasuria kulturore, sipas përkufizimit, është trashëgimi kulturore apo e mirë kulturore, e përcjellur nga brezat e mëparshëm apo që krijohen në të tashmen, atëherë Mali i Zi duhet të lavdërohet me një pasuri të jashtëzakonshme, sidomos kur bëhet fjalë për komunitetin mysliman të këtyre trevave. Qoftë trashëgimia materiale apo jomateriale.

Pasuria kulturore e komunitetit mysliman në Mal të Zi është tejet e rëndësishme si dëshimtar i së kaluarës së shtetit tonë, si pjesë e patjetërsueshme e identitetit të një populli, të lidhur drejtpërsëdrejti me Malin e Zi, me emrin dhe prejardhjen e vet. Duket se me vetëdije apo pa vetëdije shmangemi nga të vërtetat historike dhe pasuria që gjeneratat e mëhershme myslimane lënë në këto treva. Myslimanëve që janë me prejardhje nga këto troje, që kanë trashëguar historinë e popujve të këtyre trevave dhe e kanë sendërtuar gjatë historisë me kalimin në fenë islame.

Si shembull mund të përmendim historinë e Bokës së Kotorrit, në truallin e së cilës Perandoria Osmane la shenjë të thellë, që ne sot nuk jemi të vetëdijshëm apo mos përmendja e këtyre fakteve bëhet me qëllim dhe fshihet. Dyqind vite qëndrese në truallin e Bokës së Kotorrit la një shenjë të patjetërsueshme prej Herceg-Novit deri tek Orahovci, ku me



Shtëpia në Mërkot

vetëdije apo pavetëdije, do thoja me vetëdije qëllimisht humben gjurmët e së kaluarës të cilën e lanë pas vetes myslimanët që jetuan në truallin e Bokës së Kotorrit. S'ka nevojë të cekim, veçmas Sahat-Kullën në Herceg-Novi apo xhaminë në Bijella, të shkatërruar tërësisht, apo gjurmët tjera të trashëgimisë islame në Risan dhe shembujt e ngjashëm në Orahovc afër Kotorrit. Në gjysmën e fundit të shekullit XV dhe gjatë shekullit XVI, nën sundimin e osmanëve ranë qytetet e bregdetit të sotëm malazez:

Risani (1481), Herceg-Novi (1482), Ulqini, Tivari, Spiçi, Shasi dhe Budva për një kohëzgjatje të shkurtër, në vitin 1571. Kotorri dhe Perasti mbeten nën mbikëqyrjen e Republikës së Venedikut.

Luftërat për këto qytete sollën shpërnguljen e banorëve, si nga brendësia në bregdet apo bregdeti në Venedik dhe tërë Italinë e asaj kohe. Qytetet, si pasojë e lëvizjeve e ndërruan përbërjen shoqërore, kulturën dhe mënyrën e jetesës në bazë ekonomike. Gjatë sundimit osman, qyteti bregdetar me rëndësi të veçantë ishte Herceg-Novi, i cili që nga 1482 deri në vitin 1687 kishte kontrollin kryesor ndaj hyrjes në Gjirin e Bokës së Kotorrit, nën sundimin e Venedikut. Përveç Novit, Risani po ashtu ishte qendër e rëndësishme ushtarake nga viti 1482 gjer në vitin 1684.

Situata është e ngjashme në disa hapësira të tjera, ku sot myslimanët nuk janë në një numer të madh, si Nikshiqi ose Kollashini, madje edhe Podgorica.

Kur përmendet trashëgimia kulturore e myslimanëve, vëmendja është te veriu i Malit të Zi, qytetet e Plevlës, Bijello Poles, Rozhajës, Petnjicës, Plavës apo Beranit. Mirëpo, e fshehur nga opinioni, pa meritë, duhet rikthyer vëmendjen në perlën e harruar, në krahinën e Mërkotit në rrethinën e Tivarit.



Mullini Kurtoviqëve

Fisi i Mërkotit gjendet mu në mesin e Tivarit dhe Ulqinit, në vargmalin bregdetar Lisinj, në veri dhe Mozhurit në jug, me Ruminë në prapavijë dhe me dalje në det. Krahina fisnore është rrafshnaltë me fusha krastare, e rrethuar nga tri anët me maje, kurse nga e katërta me det, me një sipërfaqe rreth 90km². Sundimi më serioz turk në Mërkot fillon të ndjehet pas rënies së Tivarit më 1571. Fillimisht mërkotasit qëndruan në anën e Venedikut, por më vonë kaluan në krahun turk. Nga kjo kohë kemi shënimin e kryetarit mërkotas

Popoviq, që njëherit ishte edhe prift (“Prifti Popoviq”). Edhe pse nga turqit e fituan flamurin si krahinë e posaçme dhe ishin të veçuar në një shkallë më të lartë krahas zonave tjera, kjo qasje kohore e fillimit të sundimit turk përputhet edhe me shpërnguljen masive në veri të bregdetit, i cili që nën drejtimin e Venedikut (Dalmacia, Istra): nga periudha ndërmjet viteve 1611 dhe 1633 janë shpërngulur rreth 220 familje.

Islamizimi i Mërkotit filloi në gjysmën e parë të shekullit 17. Mirëpo, ishin raste vetjake dhe ata që u islamizuan nuk qëndruan në vendbanimin e tyre, por u shpërngulën në Tivar apo Ulqin. Nga tre shënime të Argjipeshkvisë së Tivarit, fare lehtë mund të përcillet edhe islamizimi në Mërkot: Andrija Zmajeviq, në vitin 1671 pohon se mërkotasit i takojnë ritit ortodoks; Marko Gjorga, më 1696 shkruan që tani shumica e mërkotasve janë myslimanë; dhe Vicko Zmajeviq, diku rreth vitit 1710 shënon se në Mërkot ka 140 shtëpi myslimane dhe 30 ortodokse. Kemi të bëjmë me një konvertim të hovshëm në një kohë shumë të shkurtër. Fillimisht, mërkotasit kaluan në islam për të shmangur problemet me sunduesit turq. Këtë e tregon më së miri edhe fakti se xhamia e parë në Mërkot është ndërtuar vetëm në vitin 1752, si dhe fakti se ajo u ndërtua me forca të përbashkëta të myslimanëve dhe të krishterëve, si dhe që kishat ortodokse në këtë trevë kanë mbijetuar deri sot. Islamizimi i Mërkotit nuk përfundoi kurrë gjer në fund, sepse disa nga mërkotasit e vjetër i mbeten besnik ritit ortodoks. Si simbol i ekumenizmit ndërftetar vlen të përmendet edhe kryqi i Shën Gjoni Vlladimirit, i cili që nga mesjeta ruhet në Mërkot, ku pjesëtarët e të dyja feve e ruajtën dhe e nderuan.

Islamizimi ia lehtësoi ndjeshëm pozitën Mërkotit ndërmjet dy bazave të fuqishme turke - Tivarit dhe Ulqinit. Doemos që ndërrimi i fesë ndikoi në rënien e shpirtit luftarak të këtij fisi trim. Lufta e fundit, ku mërkotasit përmenden, ka të bëjë me pjesëmarrjen e tyre në krahun e malaziasve në dyluftim me turqit në vitin 1717. Ky veprim i mërkotasve e ash-përsoi shumë autoritetin turk dhe kalimi perfundimtar në islam që rrugëdalja e shpëtim-it për ta. Ushtria Malazeze në Luftën e Madhe të vitit 1877 e çliroi Mërkotin. Gjatë veprimeve ushtarake popullata e Mërkotit u zhvendos në Shkodër, e cila ishte ende nën pushtetin turk. Pas armëpushimit, mosbesimi fillestar kundrejt malaziasve u tejkalua me ndëhyrjen e drejtpërdrejtë të knjaz Nikollës, ku popullatën e Mërkotit e bindi të rikthehet në shtëpitë e veta, ku më vonë u tjetërsuan lehtë në shoqërinë malazeze. Regjistrimi i parë në Mal të Zi i popullsisë së kësaj krahine tregon përkatësinë fetare në Mërkot. Myslimanët jetojnë në të gjitha vendbanimet dhe përbëjnë shumicën në to. Katolikë ka në Peçuricë, Ujëmirë (Dobro Vode) dhe në Mikuliqin e Vogël, kurse ortodoksë në Ujëmirë (Dobro Vode), Mikuliqin e Madh dhe të Vogël.

Kjo hyrje relativisht e gjatë në një tekst me gjatësi të kufizuar, ishte më se i nevojshëm në mënyrë që lexuesin ta njoftojë me me lëvizjet historike në krahinën e Mërkotit, e cila bart me vete edhe begatinë e saj kulturoro-historike.

Megjithatë, ekziston problem në anën tjetër, sepse trashëgimia kulturore e komunitetit të myslimanëve në Mërkot, është tejet e pahulumtuar. Përveç profesorit Mahmud Meta-noviq, qasje serioze tjetër nuk kemi.

Mërkoti, me shumicë të popullatës myslimane, veçohet me arkitekturë ku ndërlidhen rrymat e lindjes dhe perëndimit. Fshatrat e Mërkotit janë si pasojë e natyrës së egër, që gjenden në lartësi me pjerrtësi kodrinore. Si në të gjitha vendbanimet shkëmbore, guri dhe muret e thata janë karakteristike të vendit. Tarracat e punuara në këtë mënyrë japin një veçori mbresëlënëse të identitetit vizual të rrugëve dhe kalimeve. Hapësirat publike veçohen me dy elemente kryesore - lëma e grurit dhe rrota me themelin e gurit. Këto dy elemente ishin më së shpeshti pronë e përbashkët e vëllazërive dhe rreth tyre janë formuar vendbanimet - katundet e këtyre vëllazërive.

Janë tejet interesante burimet e ujit në Mërkot, ku kemi diku rreth 80 të tillë dhe ende janë në një gjendje të mirë, ku disa prej tyre kanë mbishkrime në gjuhën arabe dhe akoma nuk janë përkthyer.

Gjatë sundimit osman në shekullin XVIII dhe XIX janë ndërtuar xhamitë në Mërkot.

Xhamia në Velje Selo (Fshati i Madh) u ndërtua më 1749, kurse ajo në Goranë më 1783 (mbi themelet e këtyre xhamive u bë rindërtimi i tyre në vitin 1996), në Ujëmirë (Dobro Vode) më 1802 (meremetimi u bë më 1980-1986), xhamia në fshatin Kunje u ndërtua më



1807, xhamia në Peçuricë më 1891, kurse për atë të Leskocit nuk ka të dhëna për datën e ndërtimit.

Një ndër thesaret më të rëndësishme kulturore të Mërkotit është shkolla e hapur më 1885. Po ashtu, vend të rëndësishëm kanë varrezat nga kjo periudhë. Ato shpesh janë dëshmi e vetme historike për studimin e prejardhjes së disa fiseve dhe procesit të islamizimit të mërkotasve. Për fat të keq, sot në Mërkot nuk kemi asnjë dëshmi kadastrale, sikurse ajo e varrezave që të vërtetohet trashëgimia kulturore-historike e komunitetit mysliman.

Nga periudha osmane daton edhe Kulla (fortifikim mbrojtës) në ultësirën e Rasovcit (Leskocit), e shkatërruar pjesërisht në luftërat ballkanike. Vendbanimet 100-vjeçare janë aq të rralla sa do të ishin me të vërtetë një thesar kulturor. Posaçërisht janë tejet interesante burimet, ku ka më se tetëdhjetë të tilla dhe janë në një gjendje relativisht të mirë, ku disa prej tyre kanë mbishkrime në gjuhën arabe dhe osmanishten e vjetër, por që ende nuk janë përkthyer. Disa prej tyre janë në Peçuricë dhe në Velje Selo (Fshatin e Madh), ura gurore në lumin e Megjureshit, mullinjtë e gurit, lëma e grurit, kashtara dhe qilimat prej leshi, shtura (shtroje nga kallami), arkat e vjetra, saçi ku është pjekur buka me furrat mërkotase etj.

Duhet shtuar thesari i mbishkrimeve në mullinjtë e ujit dhe ato të ullirit, të cilët janë drejt shembjes ose tashmë të shkatërruar falë pakujdesisë dhe mos interesimit.

Në Mërkot ka edhe shumë shembuj të pasurisë gojore. Në radh të parë këtu duhet përmendur të folmen e Mërkotit, e cila dalëngadalë po harrohet, për të cilën në vitin 1969 gjuhëtari dhe hulumtuesi dr. Lluka Vujoviq ka shkruar një libër të mrekullueshëm “E folmja e Mërkotit”. Dr. Luka Vujoviq, në bazë shkencore ka vërtetuar se e folmja mërkotase është e pastër dialektike, me një ndërhyrje shumë të vogël të së folmes malazeze. Mospërzirja dhe pastërtia e kësaj të folmeje tregon edhe ndryshimin e saj karshi të folmeve tjera në territorin e vjetër të Malit të Zi. E folmja mërkotase përfaqëson atë lloj të shprehuri, ku formohet njësi dialektore në vete. Jemi munduar që edhe opinionin e gjerë ta njohim me veçoritë e këtij dialekti mërkotas, ku njëherazi shprehim edhe falënderimin ndaj autorit. Ribotimi i këtij libri u mundësua nga Këshilli Kombëtar i Myslimanëve në Malin e Zi dhe ky libër ruhet në bibliotekën e madhe të gjuhëve në Uashington.



Veshja solemne e Mërkotit

Nga ana tjetër, veshja tradicionale e Mërkotit është e veçantë. Falë Këshillit Kombëtar të Myslimanëve në Malin e Zi dhe Muzeut Popullor të Cetinës, një veshje ruhet në po të njëjtin institucion. Në punëtorinë shtëpiake punohej veshja, zakonisht nga leshi, liri, kërpi, gjineshtra e tjerë. Përbëhen nga një fanele - këmishë me mëngë të shkurtra, brageshat - brenevreket dhe këmishat e gjata prej mëndafshi, brezat e mëndafsht, jeleku - xhamadani pa mëngë, shamitë – faculeta ngjyrë bardhë nga mëndafshi, kurora dhe fjongot për mëngë.

Të shumtë janë edhe shembujt tjerë të pasurisë në trevat e banuara nga myslimanët e krahinës së Mërkotit, andaj është detyrë e hulumtuesve dhe e institucioneve, në nivel lokal dhe shtetëror, që në mënyrë serioze t'i përkushtohen kësaj, do të thojë, krahine jashtëzakonisht të pahulumtuar të Malit të Zi.

Në tekst janë përdorur këto burime:

- Prof. Mahmut Metanović, revista Glas Mrkojevića, Kulturna baština Mrkojevića, fq. 26.
- Mirsad Rašketić, revista Glas Mrkojevića, O Mrkojevićkoj kući, fq. 44.
- <https://www.poreklo.rs/2018/01/31/pleme-mrkojevici/>

Fotografite e përdorura në këtë tekst janë marrë nga portali www.glasmrkojevica.me

Gjuha, kultura dhe zakonet e romëve në Malin e Zi

Kultura e cila e ka mundur harresën në Mal të Zi: koha për t'ua hapur dyert romëve

Shkruan: Elvis Berisha

Elvis Berisha, është drejtori ekzekutiv i organizatës rinore rome “Ec me ne - Phiren amenca” dhe drejtori i portalit të parë rom RomaNet. Ai është student i studimeve specialiste në Fakultetin e Drejtësisë, dega e sigurisë dhe kriminologjisë. Ai ka qenë pjesëmarrës në gjeneratën e parë të aktivistëve të rinisë që nga viti 2011, aktiv në sektorin civil, ku është përkushtuar mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të pakicave me fokus në të drejtat e Romëve. Ai është anëtar i Grupit të Punës për Zhvillimin e Strategjisë për Përfshirjen Sociale të Romëve dhe Egjiptianëve në Malin e Zi 2021-2024. Ai është autor i botimit “Shpresa është më e fortë se frika”, 2013. Ai është redaktor dhe drejtues i emisionit “Në Labirint” transmetuar në TV Vijesti. Autor i dokumentarit “Nga Labirinti 2” si dhe i botimeve të tjera të shumta.



Të mbyllur në komunitetet e tyre, shpesh jo të gatshëm të integrohen në shoqërinë malazeze, sipas mendimeve të shumta, ata kanë ruajtur kulturën, historinë dhe gjuhën e tyre të pasur për shekuj. Romët, të njohur në të gjithë botën si ciganë (gipsy). Në të kaluarën, pothuajse kurrë nuk kishin mundësi të flisnin për veten e tyre. Të tjerët gjithmonë kanë folur për ta dhe ajo që kanë thënë ka lënë gjurmë, kryesisht negative. Kjo është arsyeja pse ne nuk jemi të befasuar nga ndonjë hulumtim mbi distancën etnike, ku hulumtimet tregojnë se shkalla më e madhe e diskriminimit është ndaj komunitetit rom. Megjithatë nuk kanë shkruar për veten e tyre, i vetmi libër që mbajnë akoma me vete, dhe e mbajnë, është gjuha e tyre romanes ose chib romani (gjuha rome).

Komuniteti rom karakterizohet nga larmia historike dhe kulturore, e mbështjellur padrejtësisht me mite, të cilat e kufizuan dhe e penguan këtë popull në trajtimin e barabartë. Romët janë pakica më e madhe etnike në Evropë, me rreth 12 milionë.

Në të gjitha vendet evropiane ata janë të marginalizuar nga popullsia dominuese. Pa histori në gjuhën e tyre, pa asnjë tendencë shtetndërtimi, romët nuk jetuan përtej kohës. Përkundrazi, historia e romëve ka ndikuar shumë në zhvillimin e të gjitha vendeve të botës me traditën, zakonet dhe kulturën e vet dhe ka ndjerë ndryshimet historike dhe përmbysjet, urdhrat, ligjet dhe luftërat që kurrë nuk u udhëhoqën nga vetë romët. Sidoqoftë, gjenocidi ndaj romëve në Luftën e Dytë Botërore është sigurisht i paharrueshëm dhe i dënueshëm botërisht.

Për të njohur identitetin e fqinjëve tanë romë në Mal të Zi, duhet të dimë nga vijën dhe cila është historia, kultura dhe gjuha e tyre.

Keni dëgjuar për „cigan”, po për historinë e popullit rom?

Romët janë me origjinë nga pjesa qendrore e Indisë, një vend i quajtur Kanauç, dhe pasi u larguan nga ai vend qëndruan në pjesën veriore të vendit të njohur si Punxhab. Fillimet e largimit nga India datojnë që në shekullin X. Sidoqoftë, grupet e para të romëve që migruan në Evropë u zbuluan në shekujt XIV dhe XV, duke lëvizur nga lindja në perëndim. Sidoqoftë, me mirëkuptim dhe pranim jo aq të mirë të romëve, sepse evropianët ishin të mërzhitur për mënyrën e veshjes dhe të jetesës së romëve, njerëzve me flokë të gjatë që jetonin nën çadra (qilima).

Në shekullin XIV, romët erdhën në Mal të Zi së bashku me turqit. Ata ishin një pjesë integrale e përbërjes administrative, ushtarake dhe ekonomike të Perandorisë Osmane. Ata prodhuan barut për ushtrinë dhe mburoja të falsifikuara. Megjithatë Perandoria kishte dëshirë që romët të regjistroheshin dhe të nguliten, disa prej tyre vazhduan të udhëtonin brenda vetë Perandorisë, por edhe jashtë kufijve të saj. Një pjesë filloi të banonte në fshatrat ballkanike, kurse pjesa tjetër vazhdoi të udhëtonte. Kjo është arsyeja pse sot kemi romë në pothuajse të gjitha vendet e botës. Skllavëria rome zgjati deri në mesin e shekullit XX. Ata kryesisht përballeshin me shumë probleme në lidhje me pranimin në shoqëri. E rëndësishme është të kujtojmë se romët kurrë nuk kanë filluar ndonjë luftë në botë dhe ata gjithmonë kanë qenë një “dëm kolateral”, gjë që do të rezultojë me migrimin e tyre të vazhdueshëm. Nëse romët në vendet e tjera do të flisnin gjuhën e tyre dhe jo

gjuhën e atij vendi, gjuhët e tyre do t'u pritëshin nga banorët e atij vendi.

Romët dhe Lufta e Dytë Botërore

E pamundur është të tregosh historinë e romëve pa përmendur trajtimin e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fatkeqësisht, si në shumë luftëra të tjera, gjatë kësaj lufte romët ishin viktimë, kësaj radhe të ideologjisë naziste. Vlerësohet se midis 250 000 dhe 500 000 romë u vranë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nuk kishte asnjë fjalë për vuajtjet e romëve, derisa Kongresi i Parë

Botëror i Romëve u mbajt në Londër, në vitin 1971. Vendime të rëndësishme u morën në këtë Kongres për fatin e romëve, të cilët ndryshuan jetën e tyre. Ata filluan të ishin më të zhurmshëm dhe më revolucionarë në luftën për të drejtat e tyre. Një nga datat më të rëndësishme për komunitetin rom është Dita Botërore e Romëve, e cila festohet më 8 prill të çdo viti. Kremtimi i kësaj date u propozua në Kongresin e Parë. Për më tepër, u mor vendim për paraqitjen e flamurit rom, pastaj himnit rom dhe emrin e romëve. Edhe emërtimi zyrtar i gjuhës zyrtare të romëve u miratua gjithashtu në këtë kongres. Romët nuk e njohin termin “cigan” në gjuhën e tyre dhe emri Roma në përkthim do të thotë “burrë”.



Gjuha rome

Gjuha rome e ka origjinën nga disa gjuhë të gjuhës popullore të afërta me sanskritishten dhe për këtë arsye ka shumë elemente themelore të përbashkëta me hinduishten, nepalishten, punxhabin dhe gjuhët e tjera simotra të Indisë veriore. Nëse i pyet romët se çfarë keni sjellë nga India dhe si e dini se jeni me origjinë nga India, ata do t'ju thonë se kjo është “gjuha rome”. Shpesh, dëgjojmë se gjuha rome është e pastandardizuar dhe kjo është arsyeja pse nuk mund ta fusim në sistemin arsimor në mënyrë që t'u japim mundë-

si fëmijëve romë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare, siç garantohet nga konventat e shumta ndërkombëtare dhe Kushtetuta e Malit të Zi. Kjo është një formë më e butë sesa kur thonë se gjuha rome është me të vërtetë thjesht zhargon i pakuptueshëm. Në vitet e fundit, megjithatë, ka pasur progres të konsiderueshëm në njohjen e historisë së gjuhës rome dhe formave të saj dialektore. Ne jemi të vetëdijshëm se gjuha rome ka pësuar ndikim në gramatikë për shkak të fjalëve të huazuara, por kjo është kryesisht për shkak të rrugës që romët kanë marrë gjatë historisë së tyre dhe qëndrimit në zona të ndryshme të të folurit.

Paraardhësit tanë, romët, ishin krenarë për gjuhën rome, sepse për ta gjuha kishte edhe një funksion tjetër përveç funksionit të saj themelor, e ai është që ta përdorin gjuhën për t'u distancuar nga mjedisi që nuk e kupton gjuhën rome. Kjo gjë në njëfarë mënyre evokonte një ndjenjë epërsie, sepse ata e kuptojnë gjuhën lokale ose zyrtare të popujve të tjerë, por të tjerët nuk e kuptojnë gjuhën e tyre. Megjithatë, tani është koha për ta ndryshuar këtë. Nëse duhet të mësoj gjuhën e popujve të tjerë në mënyrë që të funksionoj, atëherë mendoj se të tjerët duhet ta mësojnë gjuhën time nëse duan. Në çdo rast, është e nevojshme të sigurohet një mundësi që të gjithë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare dhe që gjuha rome, si dhe gjuhët e tjera evropiane, të njihen si gjuhë e veçantë, e barabartë, e cila do të funksionojë në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Gjuha rome ka 38 shkronja. Fakti që është gjuhë e pasur dëshmon se përveç shtatë lakimeve, aq sa ka në gjuhën malazeze, ekziston edhe lakimi i tetë, i quajtur “ablative”. Romët kurrë nuk e quanin veten “ciganë” në gjuhën e tyre, sepse ky term nuk ekziston në gjuhën rome. Ata thonë për veten: Me sem Rom (Unë jam rom). Përkundër të gjitha ndryshimeve historike që ka pësuar gjuha rome, miliona njerëz e flasin atë në të gjithë botën, dhe ka rreth katër milionë folës vetëm në Evropë. Kjo do të thotë, nëse e krahasojmë me të dhënat nga regjistrimi i vitit 2011 në Malin e Zi, se ka 20 herë më shumë folës sesa ata që e kanë gjuhën malazeze gjuhë amtare.

Kultura e romëve

Tradita është shumë e rëndësishme te romët. Jeta rome është e ngjashme me jetën e kohës së tanishme. Brezi i ri respekton fjalën e të moshuarit, ndonjëherë edhe pa dëshirë. Prindërit nuk lihen në asnjë rast në shtëpitë për të moshuarit. Gratë duhet të jenë të bindura ndaj burrave, fëmijët ndaj prindërve, djemtë kanë një privilegj më të madh se vajzat, por edhe një vajzë respektohet. Atyre u pëlqen të dëgjojnë në orët e vona të natës, afër

zjarrit, historitë e vjetra, legjendat që përcillen nga brezi në brez.

Prindërit vendosin dhe i gjejnë bashkëshortët për fëmijët e tyre. Por ka gjithnjë e më pak nga këta shembuj, pasi brezat e rinj tani po gjejnë vetë bashkëshortët. Me këtë, vetë komuniteti rom iu është përshtatur ngadalë të rinjve dhe ka treguar pjekuri për zhvillimin e komunitetit. Sidoqoftë, ky proces është kompleks dhe kërkon mbështetjen e shoqërisë, veçanërisht të institucioneve shtetërore. Nuk është e pazakontë që një nuse të paguhet me para dhe vetë anëtarët e komunitetit rom nuk e konsiderojnë atë një shitje të fëmijës së tyre, por traditë. Në rast martesë me një person të kombësisë tjetër (gaxhe), fëmijët nga marrëdhëniet e tilla, nëse rriten në “mënyrën tradicionale”, do të konsiderohen romë.

Festat në kulturën dhe traditën rome

Sipas një sondazhi të kryer nga Organizata Rinore Rome “Hapëroni me ne - Phiren Amenca”, në mesin e nxënësve të shkollave të mesme nga të nëntë shkollat e mesme në Podgoricë, 955 prej tyre, madje 74 për qind nuk e dinë se cilat janë këto festime në kulturën dhe traditën rome. Ata që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, 23 për qind e tyre, thanë se Dita e Shën Gjergjit është një festë e romëve, një përqindje e vogël e tyre përmendën Bajramin dhe Vasilicën si një festë të romëve. Pra, vetëm një nxënës i shkollës së mesme e dinte që romët e festojnë Vasilicën dhe pothuajse asnjë nga të tjerët nuk kishte njohuri për atë që romët festojnë. Kjo shifër është alarmante për Malin e Zi, një shtet shumëetnik dhe shumëkonfesional.

Vasilica

Vasilica fillon më 14 janar, në varësi të vendit ku jetojnë romët dhe zgjat deri në tri ditë, ndërsa në disa vende madje zgjat deri në fund të janarit. Pastaj, kafshët me pendë ofrohen si viktimë, kryesisht në numër tek, dhe numri varet nga pasuria dhe numri i anëtarëve të familjes.

Bibi (tezja)

Bibi (tezja) është perëndeshë dhe legjendë rome që tregon se si një familje e varfër rome kishte një person të sëmurë në shtëpinë e tyre dhe se si ata i luteshin Zotit për ta shëruar.

Atë mbrëmje një grua e panjohur (Bibi) pyeti nëse mund të kalonte natën me ta, por meqenëse ishin të varfër, nuk kishin ku ta vendosnin, kështu që i ofruan asaj pak hapësirë pranë furrës me dru, të cilën ajo e pranoi. Gjatë natës Bibi u ngrit dhe doli jashtë, gjë që e zgjoi zotin e shtëpisë dhe ai vërejti nga dritarja kur ajo arriti te pema dhe u zhduk. Në mëngjes u zgjua plotësisht i shëndetshëm dhe familja menjëherë arriti në përfundimin se teza (Bibi) ishte përgjigjja e lutjeve të tyre.

Bibi festohet së paku dy ditë dhe dita e parë u kushtohet të vdekurve dhe nuk ka festim atë ditë. Vizitohen varrezat dhe ushqimi iu çohet të vdekurve të tyre. Ditën e dytë, pema më e madhe dhe më e trashë kërkohet në fund të qytetit ose fshatit, ku ata i sjellin dhurata tezes dhe i lënë atje. Në atë ditë, vendoset nikoqiri, i cili duhet të organizojë të gjitha ato, dhe nikoqiri i asaj mbrëmjeje, ku duhet të vijnë të gjithë romët e atij vendi.

Erdelezi (Dita e Shën Gjergjit)



Erdelezi (Dita e Shën Gjergjit) është një festë treditore, ku dita e parë është dita më solemne kur qengjat flijohen për hir të Zotit të pranverës dhe është detyrim për çdo familje ta bëjë këtë. Ajo përkon si datë me festën ortodokse të Shën Gjergjit, por nuk ka asnjë lidhje me atë festë. Mirëpo, ka shumë që i përziejnë këto dy festa. Erdelezi është fillimi i verës për romët dhe pas kësaj feste ata i lëshojnë vendet e tyre të banimit në dimër dhe shkojnë në të ashtuquajturin “megrim” gjatë gjithë verës, dhe kthehen në nëntor.

Femra Rome gjatë festimit të Erdelezi festës, burimi: Internet

Gjuha, kultura dhe zakonet e serbëve në Malin e Zi

Pse harresa është mëkat

Shkruan: Mr. Millorad Durutoviq

Millorad Durutoviq lindi më 10 maj 1984 në Nikshiq. Ai u diplomua dhe mori gradën master në Fakultetin Filozofik në Nikshiq. Tani është student doktorant në Fakultetin Filozofik në Mitrovicë të Kosovës. Për pesë vjet ai punoi si bashkëpunëtor i mësimdhënies në Fakultetin Filozofik në Nikshiq. Ai është anëtar i Bordit Ekzekutiv dhe Departamentit për Gjuhën Serbe të Matica Srpska - Shoqata e Anëtarëve në Mal të Zi; Ai është bashkëautor i librit I, Nikola Tesla. Ai është redaktor i forumit ndërdisiplinor Bios Theoretikos, i cili afirmon shkencëtarë të rinj nga Mali i Zi. Isshtë fitues i çmimit të Brankos për tezën e diplomës “Qielli dytësor - Kozmogonia poetike e Vasko Papës” (2010).



Të gjithë që kujtojnë dhe praktikojnë me respekt mësimet e paraardhësve të tyre, mësuesve, artistëve, shkencëtarëve, heronjve historikë dhe kombëtarë, janë të kulturuar. Kultura presupozon gjithmonë një lloj vazhdimësie, një lloj pasurimi dhe modifikimi të vlerave ekzistuese. Prandaj, kultura nuk është e mundur pa kujtesë. Prandaj është shumë i shpeshtë nocioni kultura e kujtesës. “Duke kujtuar” - thotë poeti dhe eseisti Miodrag Pavloviq – “një person në tërësi e vështron jetën e vet, reflekton veprat e veta, kupton më thellë ngjarjet e përgjithshme ku merr pjesë, si degë, si rrjedhë. Kujtesa për individët, grupet dhe popujt është ruajtja dhe ripërtëritja e formës së vet, udhërrëfyes dhe nxitje në veprimtarinë e mëtejshme, në sipërmarrje, në gjetjen e veprimeve dhe formave të reja.

Sidoqoftë, koha jonë më parë sjell pohimin e harresës sesa të kujtesës. Në të vërtetë, çfarë do të mbetej nga një komb nëse faqet do të fshiheshin nga kujtesa e tij kulturore, dhe madje edhe ato që dëshmojnë për arritjet më të larta etike, arsimore,

profesionale ose kalorësiake?! Mund të jetë e tepërt për t'u shkruar përgjigjja, por pyetja në vetvete në këto kohë më moderne ka rëndësi dramatike.

Sidoqoftë, nëse pranojmë vrojtimin e Alaida Asman se “ajo që ne e quajmë harresë, si rregull, është një kujtesë e fshehtë për të cilën kemi humbur kodin, atëherë ne e kuptojmë pse të harrosh, të paktën në planin afatgjatë, është një institucion i pamundur”. Gjegjësisht, ka gjithmonë të paktën një njeri që kujton, i cili gjen kode të kujtesës së ndrydhur me të cilat mund të zbulohet një e vërtetë e rëndësishme. Falë profesorit Veselin Matoviq, dhjetë vite më parë, u zbulua një faqe sublime e së kaluarës së Malit të Zi. Bëhet fjalë për qëndrimin e nderuar dhe kalorësiak të një grupi mësuesish nga Bjellopavliqi të cilët, kundrejt rrezikut të jetës së tyre, ishin të gatshëm të mbrojnë kulturën, gjuhën dhe shkrimin serb. Okupimi i Malit të Zi nga ana e Austro-Hungarisë, kundrejt tmerreve të ndryshme, sjell ndalimin e alfabetit cirilik në shkolla, përjashton nga procesi mësimor këngët heroike dhe patriotike serbe, sikur dhe lëndën “Historia serbe” me urdhër të gjeneralit Viktor Veber (shih më detajisht V. Matoviq, Ćirilica dhe latinogorica, Podgoricë - Nikshiq, 2013). Këtë urdhër me vendosmëri e kundërshtojnë: Vuksan Radoviq, Savo Gjurovqi, Velizar Gjuranoviq (tre muaj kaluan në burg), Ilija Mijushkoviq, Tripko Brajoviq, Andrija Dragoviq, Savo Jovoviq, Tomo Dragoviq, Radovan Popoviq, Milladin Vujadinoviq, Novo Vuçiniq, Bllazho Radonjiq, Cvetko Stanishiq dhe Jaksha Brajoviq (të dënuar me katër apo më tepër muaj burg). Përveç tyre janë dënuar tre juristë, Nikolla Dragoviq, Marko Joviqeviq dhe Radovan Boshkoviq. Ata u akuzuan se nxitnin rebelimin e mësuesve.

Mësuesit dorëheqjet e veta i nënshkruajnë veçanërisht në komandën ushtarake në Danillovgrad, më 19 tetor të vitit 1916. Arsyetimi i tyre i përbashkët thotë:

Alfabeti cirilik është historia serbe – arteria, aorta e nacionalizmit serb, ne jemi të gatshëm të jemi mësues serbë dhe nuk duam të jemi antikombëtarë. Për të mbetur të denjë ndaj profesionit të mësuesit serb në Mal të Zi, jemi të nderuar të lajmërojmë komandën se me këtë japim dorëheqje në detyrën tonë. Të gjithë gjurmët kulturore të kombit tonë janë shënuar me alfabetin cirilik, të mos mësojmë historinë kombëtare do të thotë të heqim dorë nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja.

Nuk është e rastit që profesori Veselin Matoviq ktheu në kujtesën tonë kujtimin ndaj mësuesve të guximshëm, pasi që me 26 kolegët e tij u pushua nga puna, para 15

viteve, duke qenë se kundërshtoi vendimin e Ministrisë së Arsimit dhe Këshillit për Arsim të Përgjithshëm lidhur me riemërtimin e lëndës mësimore Gjuhë dhe letërsi serbe në Gjuhë dhe letërsi amtare (serbe, malazeze, boshnjake dhe kroate).

Lufta për ruajtjen e gjuhës serbe dhe shkrimin cirilik në Malin e Zi të sotëm është dykahëshe. Në njërin anë, lufta për të ruajtur mësimet e të parëve, identitetin historik dhe kulturor të Malit të Zi, kurse në anën tjetër, lufta që të ruhet identiteti kombëtar i serbëve sot në Malin e Zi. Pa kujtesë aktive të historisë gjuhësore serbe dhe shkrimin cirilik, nga Ungjilli i Miroslavit, përmes shtypshkronjës së Černojeviqëve, veprimtarisë së Vuk Karaxhiqit, identiteti kombëtar dhe kulturor do të ishte madje i pamundur, sepse korniza e sotme institucionale nuk pasqyron frymën historike. Gjuha serbe ka gëzuar status të gjuhës së privilegjuar, zyrtare, shtetërore, gjatë gjithë etapave historike të Malit të Zi. Ja një përkujtesë për për këtë. Duke shkruar për testamentin e Gjergj Černojeviqit, vejusha e tij shprehet: „...realizuar përmes një përkthyesi të besueshëm, nga gjuha serbe në gjuhën latine, me dorën e vet, nga vetë i ndjeri zotëri Gjergj Černojeviqi...”



*Faksimili faqës parë të Ungjillit të Miroslavit – Burimi: <https://bs.wikipedia.org/wiki/Miroslav>
 [Ungjilli i Miroslavit është shkruar kah fundi shekullit XII. I punuar për vëllaun e Stefan Nemanjës, knezin Miroslav. Më shumë gjasa është krijuar në Bijelo Polje për nevojat e kishës së Shën Pjetrit Monumenti original ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Serbisë]*

Ose, për shembull, i famshmi Bozhidar Vuković Podgoričanin shkruan në Venedik: „Dëshirova shkronjat tona serbe (...) në fjali t'i rendis“ (Parathënie e Lutjeshkrimit, 1520). Në librin e gjeografisë të Mbretërisë së Malit të Zi për nxënësin e klasës së tretë të shkollës fillore (shkruar nga Gjuro Popović dhe Jovan Radović, Shtypshkronja e Shtetit Cetinë, 1895) hasim: „Në Mal të Zi jetojnë serbë të pastër dhe të vërtetë, të cilët flasin gjuhën serbe“. Në Ligjin për shkollat popullore në Mbretërinë e Malit të Zi (Cetinë, Shtypshkronja e Shtetit, 1907) thuhet: „Neni 1. Detyra e shkollave popullore është t'i arsimojnë fëmijët në frymën popullore dhe religjioze dhe t'i përgatisin për jetën qytetare, sidomos të përhapin arsimin dhe shkrim-leximin serb në popull...“ Të mos flasim, më në fund, se pothuajse e tërë letërsia e krijuar në hapësirën e Malit Zi të sotëm deri në shekullin XXI është shkruar në gjuhën serbe.

Harku gjuhësor dhe kulturor serb, që nga Ungjilli i Miroslavit, përmes Njegoshit, deri tek autorët Borisllav Pekiq dhe Novica Tadiq, është më se i denjë për traditën më të mirë kulturore të Evropës. Por, megjithatë, sot kemi ardhur në kohën kur kultura është gjithnjë e më pak një qëllim i komunitetit të emancipuar, por shndërrohet për më tepër në mekanizëm të intrigës politike. Në thelbin e vet, kultura është mbi-kombëtare, por kjo nuk do të thotë se është jokombëtare. Prandaj, dhe një herë, nënvizoj sa me rëndësi është për serbët në Malin e Zi që në rrethana aktuale shekullore të kultivojnë kulturën e kujtesës; të mbajnë mend se si dhe pse:

- Bozhidar Vuković Podgoričanin ka shtypur Tekstin liturgjik festiv (1538), të cilin ia dhuron manastirit Hilandar, duke e dekoruar paraprakisht me ilustrime të Shën Savës, Shën Simeonit të Serbisë, Shën Stefanit të Deçanit, dhe Shën Nikollës (Shënkollit);
- Njegoshi në Kurorën e Maleve e kodifikon etikën e Ditës së Shën Vedit;
- Mark Milani çon fjalë: “Si një kuças do të vdes mjaft i lumtur, por si një serb do të vdes i palumtur dhe i pakënaqur”;
- Stjepan Mitrov Lubisha thotë: “Unë kurrë nuk i kam takuar asnjë partie popullore, por që nga Kosova i takoj asaj kombësie serbe fatkeqe, por heroike dhe krenare, të cilën e respektojnë dhe e nderojnë edhe armiqtë e saj”;
- Mbreti Nikollë shumë herë në veprat e veta shpreh kombësinë e vet serbe dhe se është ithtar i dogmës së Shën Savës;
- Petar Llubarda me dorën e vet e shkruan biografinë, ku thotë: “Kam vendosur që t'i nisi këto të dhëna biografike, të cilat të vetmet janë të sakta për mua. Këto

janë: Petar Llubarda, i lindur më 1907 në Lubotinj; serb, jeton në Beograd, Rruga Illiqjeva nr. 1;

- Krahina e Pivës i jep katër patriarkë serbë;
- Petar Perunoviq Perun, lahutar i famshëm nga fshati Drenoshticë, përhap famën e lahutës serbe nëpër Evropë dhe Amerikë, por si oficer i ushtrisë serbe dekorohet me tetë dekorata më të larta të luftës;
- Në tekstin shkollor të Gjeografisë së Mbretërisë së Malit të Zi për nxënësit e klasës III të shkollës fillore (1911), autorët Gjuro Popoviq dhe Jovan Roganoviq thonë: “Secili serb në Mal të Zi është i detyruar ta dojë mëmëdheun, si dhe të gjitha tokat serbe ku jetojnë, të çliruar dhe të paçliruar, vëllezërit tanë serbët...”
- Me dekada në Kotorr ka ekzistuar Garda Popullore Serbe, e themeluar në vitin 1862. Në këtë qytet është themeluar edhe Kori më i vjetër, më i respektuar dhe në përmasa ndërkombëtare më i njohur, që e mban emrin Kori Serb Bashkimi. Është themeluar në vitin 1839, dhe pa ndërprerje punon deri në ditët e sotme;
- Medalja e Obiliqit është dekoratë ushtarake për trimëri të cilën e ka themeluar Njegoshi, në vitin 1847, dhe e kanë dhënë edhe sovranët e radhës pas tij;
- Në Principatën dhe Mbretërinë e Malit të Zi është respektuar Shën Sava si festë shkollore, por edhe për praninë e traditës së dogmës së Shën Savës tregon edhe fakti se me dhjetëra vëllazëri malazeze e festojnë ditën e Shën Savës si festë fisnore, ndërsa 14 tempuj që ndodhen në territorin e Malit të Zi të sotëm i janë kushtuar Shën Savës. Mos të flasim për dhjetëra toponime që, po ashtu, sinjalizojnë se sa është i zhvilluar kulti i Shën Savës në Mal të Zi.

Qenia kulturore, kombëtare, intelektuale dhe shpirtërore serbe ka formuar dhe ruajtur historikisht Malin e Zi. Unë kam veçuar disa shembuj përfaqësues këtu, por qindra mijëra prej tyre mund të shtohen. Por këtu qëllimi është i thjeshtë, për të treguar se nuk ka asnjë sferë të jetës shtetërore, kombëtare, fetare, ushtarake, intelektuale dhe artistike të Malit të Zi që nuk dëshmon për vazhdimësinë shekullore të kulturës serbe në Mal të Zi.

Mirëpo, potenciali i dokeve popullore, të ruajtura qysh në kohët pagane deri sot në format më të ndryshme, po ashtu dëshmon elemente specifike të kulturës serbe. Në librin Jeta kishtarë në Mal të Zi në shekullin 18 dhe 19 Slobodan Boban Jokiq përmend një sërë traditash të tilla që janë kistianizuar gjatë kohës apo kanë marrë pëlqimin e kishës dhe në këtë kontekst janë bërë pjesë e traditës mes serbëve në Mal të Zi. Tradita të tilla paraqesin binjakëzimi dhe birësimi. Mirëpo, kur bëhet fjalë për



hapësirën e Malit të Zi, për dallim nga vendet tjera ku jetojnë serbët, festat fetare janë ngritur në nivel të kultit. Festimi i mbrojtësit familjar ka prapavijë pagane, por në kontekstin kristian ka konotacion plotësisht ndryshe. Ndër shekuj, festa familjare, e cila nuk është pjesë e traditës së popujve të tjerë ortodoksë, është trajtuar më tepër si festë kombëtare sesa fetare. Mund të thuhet, madje, që festa familjare si festë kombëtare e fetare është praktikuar pa ndërprerje prej periudhës së pagëzimit, qoftë edhe në periudhat e skllavërisë dhe luftërave. Qëllimi ishte ruajtja e vazhdimësisë nacionale dhe kulturore, diçka që cekëm në hyrjen teorike të këtij punimi. Shenjtori që shënohet si pjesë e festës familjare përcakton lehtë cilit fis apo vëllazëri i takon ai që feston.

Për hir të qindvjetorit të lindjes së Petrit II Petroviq Njegoshit (Ftesa) – Burimi: Mali Zi: populli, gjuha, kasha- nëpërmes dokumentave historike, redaktorë Jovan Markush, Podgoricë: 2019.

[Ftesa për festimin e qindvjetorit të lindjes së Njegoshit – origjinali ruhet në Bibliotekën Qëndrore Kombëtare në Cetinë]

Shën Nikolla (19 dhjetor) dhe Arkangjeli Mihail, Arangjelovdan (Dita e Arangjelit - 21 nëntor) janë festat familjare më të shpeshta të serbët e Malit të Zi; i pari si mbrojtës i rrugëtarëve dhe detarëve pasqyron karakterin mediteran të Malit të Zi, kurse Arangjelovdan është

posaçërisht i rëndësishëm, sepse ishte festa familjare e Nemanjiqëve. Po ashtu, për serbët në Malin e Zi rëndësi të madhe ka edhe e ashtuquajtura prislava (festë tjetër, e cila shënohet në mënyrë më modeste, me më pak mysafirë sesa festa krishtere zyrtare – shënim i përkthyesit). Nëse festa familjare do të ishte në periudhën dimërore, festës familjare i shtohet ndonjë prislava, që ishte në periudhën pranverore apo verore. Kjo është karakteristikë e viseve malore të Malit të Zi ku për shkak të kushteve të vështira grumbullimi i familjarëve të afërt nuk mund të organizohej. Përveç festave të përmendura, rëndësi të veçantë në Mal të Zi ka festa e Shën Savës.

Në librin për klasën e katërt të shkollës fillore, viti 1909, të autorit Gjuro Popoviq, shtypur në Cetinë, shkruan: „Çdo shtëpi serbe ka një ditë në vit, të cilën e feston posaçërisht. Këto festa janë nga periudha kur të parët tanë kanë kaluar nga besimi i tyre në shumë zota në krishterizëm. Të gjitha shkollat serbe dhe të gjithë nxënësit serbë e festojnë Shën Savën, edukatorin e parë serb”.

Në fillim të këtij teksti u bë shqyrtim i mendimit të Miodrag Pavloviqit mbi aktin e përkujtimit, por unë me vetëdije lashë diçka për fundin, për të cilin paralajmëron Pavloviq. “Kujtesa mund të çojë në çmenduri, e cila mund të shihet në njerëz shumë të fiksuar me traditë, kujtesa mund të mbushë individë dhe grupe me melankolinë e thellë, dhe së fundmi, kujtesa mund të shkatërrojë diçka shumë të çmuar, çfarë është vetë tema e kujtesës. Ata mund të prishin, shpërfytyrojnë kujtimet e tyre, që deri atëherë qëndronin të fshehura tek ata dhe të afta për të vepruar fisnikërisht, duke shkaktuar rrezatime të pamjaftueshme të pashpjegueshme tek ne”.

Nëse, pra, problemi i harresës vihet në dukje në fillim, është e rëndësishme të kihet parasysh se kujtesa mund të ketë gjithashtu pasoja drastike për shëndetin shoqëror (dhe mendor). Duket se në Malin e Zi nuk ka asnjë konflikt shoqëror, kulturor ose kombëtar që nuk është pasqyrim i një të kaluarë të afërt ose të largët. Dhe të gjithë shkojnë atje, madje edhe ata që u kanë mbushur gojën me të ardhmen. Por është një histori e veçantë që dikush shkon për ta vërtetuar dhe dikush për të fshirë të vërtetën.

P.S. Jam i vetëdijshëm për kritikat e mundshme, që ky tekst ka një metodologji tepër jonormative.



Gusllat serbe [...], këndon gusllari popullorë Petar Perunoviq Perun / Recorded by Marsh Laboratories, Chicago 1920s – burimi: <https://vido-vdan.org/istorija/petar-perunovic-perun-guslar-koji-je-pevao-pupinu-i-tesli/>

Prandaj, do t'u sugjeroja disa botime të cilave mund t'u referohen, ku trajtohen të gjitha problemet që lidhen me statusin e kulturës, gjuhës dhe shkrimit serb në Malin e Zi të sotëm, në mënyrë shkencore *par excellence*.

Literatura e përdorur:

- Веселин Матовић, Ноћ дугих маказа: потискивање српског идентитета у црногорским уџбеницима за језик и књижевност, Подгорица: 2012.
- Андрија Јовићевић, Древни српски манастири, Подгорица: 2012.
- Веселин Матовић, Ћирилица и латиногорица, Подгорица: 2015.
- Јелица Стојановић, Пут српског језика и писма, Београд: 2017.
- Српско језичко наслеђе на простору данашње Црне Горе и српски језик данас. Зборник радова са Међународног научног скупа одржаног у Херцег Новом 20-23. априла 2012. године, Подгорица: 2012.
- Владимир Лепосавић, Ухваћени у вршењу својих права, Подгорица: 2017.
- О. Слободан Бобан Јокић, Црквени живот у Црној Гори у 18. и 19. вијеку, Подгорица: 2018.
- Црна Гора: народ, јазик, црква – кроз историјска документа (përg. Јован Маркуш), Подгорица: 2019.



Ministritë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave në Malin e Zi